

# Kumbona e së Diellës



Shën Pjetër, Romë, me 27 prill 2014, me rastin e Shenjtërimit të Papëve.

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT  
Nr.5/6, Maj - Qershor 2014

# KUMBONA E SË DIELLËS


## Revista qe për 76 vite rrezatoi besim dhe kulturë

Ndër botimet klerikale krahas teksteve shkollore, një vend të veçantë e zënë të përkohshmet, revistat, organet e ndryshme të shtypit me përmbajtje fetare, letrare, gjuhësore, pedagogjike, historike etj., qe ndihmuan në zgjerimin e horizontit kulturor të popullit tonë. E para e botuar në gjuhën shqipe ishte “Elçia e Zemers t' Jezu Krishit” botuar nga Etërit Jezuit në Shkodër, në vitin 1891. Në vitet në vazhdim një e tillë ishte, Kumbona e se Diellës.

Revista Kumbona e së Diellës, ka filluar të dalë në janar 1938. Ishte revistë katolike “E përkohshme fetare – kulturore”, dedikuar të gjitha kishave katolike në Shqipëri. Revista është botuar nga zyra famullitare e Shkodrës, me lejen e Kurijes Arqiepeshkvore të Shkodrës. Drejtor – përgjegjës, nga fillimi deri në mbyllje të vitit 1944, ishte famullitari i Shkodrës Dom Mikel Koliqi. Nga viti 1938-1941, për çdo vit janë botuar nga 12 numra të revistës. Ndërsa, gjatë viteve 1942-1945, revista ishte e përjavshme dhe janë botuar 52 numra në vit. Ndërsa, në vitin 1944 i cili ishte dhe viti i mbylljes janë botuar 50 numra. Nga 1940-1944, revista është botuar si organ i “Famullive Katolike të Shqipërisë” e si organ i “Veprimit Katolik të Shqipërisë”, me drejtor të mëshëm me qendër në Shkodër. Revista nga viti 1938-1941, botohej në shtypshkronjën Jezuite “Zoja e Paperlyeme”. Gjatë vitit 1942, në shtypshkronjën “Cirka”, kurse në vitet 1943-1944, në shtypshkronjën.” Shqypja”.

Revista kishte përmbajtje të larmishme, si: tema liturgjike kishtarë e biblike, morale, edukative, tema nga historia e kishës shqiptare e botërore, nekrologji, prezantime librash, lajme kishtarë nga bota dhe kisha shqiptare etj.. Numri i fundit para mbylljes definitive ishte me 10 dhjetor të vit 1944.

Pas demokratizimit të vendit, revista “Kumbona e se Diellës”, filloj të botohej në korrik të vitit 1992, me



të njëjtin emër e përmbajtje si me parë, organ i Famullive të Arkidieqezës Metropolitane Shkodrës, duke dalë 6 numra gjatë këtij viti. Ndërsa, në vitin 1993, janë botuar vetëm 8 numra. Rivista edhe përse cilësohej “E Përnuajshme fetare-Kulturore”, nga viti 1992-1999, e ndjeve mungesën e botimit të disa numrave. Nga viti 2000 deri në janar-shkurt 2004 është botuar si dymujore, duke dalë nga shtypi në kohën e caktuar. Nga fillimi i ri i botimit 1992 deri në janar- shkurt 2004, drejtues ishte dom Zef Simoni, kryeredaktor, Kolec Çefa. Nga muaj, mars-prill 2004 deri sot, revista vazhdoi të botohej për çdo dy muaj, me të njëjtin përmbajtje, fetare e kulturore, si organ i Kryedieqezës Metropolitane të Shkodrës, gjegjësisht Shkodër-Pult, me drejtor Imzot Angelo Massafra dhe redaktor Dom Nikë Ukgjini. Revista fetare e kulturore, Kumbona e se Diellës, e cila ruajti titullin fillestar, mbush 76 vjet jete.







|                                      |    |
|--------------------------------------|----|
| Radio Vatikani                       | 4  |
| GJONI XXIII E PALI II JANË SHENJTORË |    |
| Redaksia                             | 6  |
| PAPA GJON PALI II                    |    |
| Don Lushi Gjergji                    | 8  |
| PAPA GJONI XXIII                     |    |
| Radio Vatikani                       | 13 |
| PAPA FRANÇESKU BASHKON NË LUTJE      |    |
| Don Nosh Gjollaj                     | 16 |
| FAKTORËT QË SHKATËRROJNË FAMILJEN    |    |
| Dom Nikë Ukgjini                     | 20 |
| KISHA KATOLIKE DHE SFIDAT            |    |
| Redaksia                             | 24 |
| MENTOR QUKU - JETA DHE VEPRA         |    |
| Frano Kulli                          | 25 |
| LAMTUMIRE MJEDOLOGUT                 |    |
| Begzad Baliu                         | 26 |
| STUDIUESI QË NGRITI MONUMENTIN       |    |
| Redaksia                             | 29 |
| DEKORIMI I PROF. MENTOR QUKUT        |    |
| Mentor Quku                          | 30 |
| LETRA PËRSHËNDETËSE                  |    |
| Kronisti                             | 31 |
| TITULLI PROFESOR NDERI               |    |
| VITRINA E LIBRIT                     | 32 |

## KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXIX, nr. 5/6 (464-465) Maj - Qershor 2014

Revistë  
Fetaro-Kulturore  
Drejtues  
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia  
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)  
Atë Mario Imperatori S.I.  
Dom Gjovalin Sukaj  
Loreta Tomaj

Adresa:  
Arqipeshkvia Shkodër  
Sheshi Gjon Pali II  
Tel. 0222-42764  
Fax. 0222-43673  
e-mail: n\_ukgjini@yahoo.it  
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

**GJONI XXIII E GJON PALI II JANË SHENJTORË**  
**Papa Françesku: “nuk patën frikë të përkulen mbi plagët e Jezusit”**  
*Vatikan 27 prill 2014.*

*Një përqaftim mes Papa Françeskut dhe paraardhësit të tij Benediktit të 16-të  
hapi ceremoninë solemne të kanonizimit shënjtorë të Papa Gjon Pali II dhe Papa Gjoni XXIII.  
Në ceremoni mori pjese dhe kryetari i Konferencës ipeshkvore të Shqipërisë Mons. Angelo Massafra.*

Dy Papë Shenjtorë, dy Papë bashkëkremtues. Në këto gjashtë fjalë përmbledhet gjithë karakteri i jashtëzakonshëm i kësaj dite, historike për Kishën, festë feje e ditë shprese për njerëzimin. Që nga orët e para të mëngjesit, një turmë pa fund besimtarësh, të paktën 800 mijë vetë, u dynd në Sheshin e Shën Pjetrit, në Udhën e Pajtimit e në zonat rreth Kështjellës së Shën Engjëllit, për Meshën e shenjtërimin të Gjonit XXIII e Gjon Palit II, kryesuar nga Papa Françesku.

Më se 800, bashkëkremtuesit, ndërmjet të cilëve, Papa i nderit Benedikti XVI, i përshëndetur me një duartrokitje të stuhishme në sa hynte në treme, e edhe ipeshkvijtë e Kishës Katolike të Shqipërisë, kryetari i Konferencës Ipeshkvnore, Kryepeshkvi i Shkodër-Pultit, Imzot Angelo Massafra dhe Kryepeshkvi i Tiranë-Durrësit, Imzot Rrok Mirdita.

Nga autoritetet zyrtare, kujtojmë praninë e Presidentes së Kosovës, Zonjës Atifete Jahjaga dhe të Kryeministrit, zotit Hashim Thaqi. Shqipëria, veç

ipeshkvijve, përfaqësohej nga shumë grupe të vogla emigrantësh e shtegtarësh, ardhur nga i gjithë vendi, për t'u shprehur dy papëve Shenjtorë mirënjohjen e thellë, për ndihmesën që dhanë, ndërmjet tjerash, në shembjen e perdes së hekurt. Gjatë homelisë, në të Dielën titulluar nga Papa Vojtila e “Mëshirës Hyjnore”, ipeshkvi i Romës pohoi se dy shenjtorët nuk patën frikë të përkuleshin mbi plagët e Jezusit. Mbi ato plagë që janë shenja e përhershme e dashurisë së Zotit për ne.

Shenjtorë! Gjoni XXIII e Gjon Pali II janë shenjtorë. Dëshira e zjarrtë e disa breznive besimtarësh, që e prisnin këtë shpallje, u bë kumt koral gëzimi për Kishën e botën mbarë. Kremtimi filloi pikërisht me Litanitë e Shenjtorëve, kënduar nga Kori i Kapelës Sikstine e menjëherë u ndje fort fryma e përqendrimit të thellë në lutje dhe ndjekja me heshtjen, që pushton katedralet katolike në kremtimet e mëdha. Qetësi surreale, në një turmë qindra mijëra vetësh. Për të ndjekur ritin sugjestiv, në latinisht, gjatë të cilit kardinali prefekt i



Kongregatës për Çështjet e Shenjtorëve, Angelo Amato, i drejtoi tri herë rresht Papës petitionin për të shkruar në Albumin e Shenjtorëve Gjonin XXIII e Gjon Palin II. Pastaj, çasti i prituri me një emocion të papërshkrueshëm: formula e Kanonizimit: "... Beatos Ioannem XXIII et Ioannem Paulum II Sanctos esse decernimus et definimus, ac Sanctorum Catalogo adscribimus...".

"Deklarojmë dhe përkufizojmë Shenjtër të Lumët Gjoni XXIII dhe Gjon Pali II, i shkruajmë në Albumin e Shenjtërve dhe caktojmë që të nderohen me devocion ndër shenjtorë, në të gjithë Kishën. Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit të Shenjtë". Janë fjalët që, një çast pasi dolën nga goja e Papës Françesku, hynë në librin e historisë së njerëzimit. Pasuar nga një *Amen* shpërthimtar e edhe nga duartrokitjet e stuhishme të mijëra njerëzve, sytë e të cilëve nguleshin në fasadën e Bazilikës, mbi portretet e dy Papëve Shenjtorë, që duket sikur rinisën dialogun e tyre të gjallë e të gjatë, me botën. Riti i kanonizimit pati edhe një çast tjetër prekës, atë të vendosjes së relikteve të shenjtorëve në Altar. Relikuarin e Shën Gjon Palit II e mbarti Floribeth Mora Diaz, që u shërua mrekullisht nga Shenjti. Ndërsa atë të Gjonit XXIII, katër nipat, kryetari i bashkisë së Nënmalit dhe kryetari i Fondacionit kushtuar Papës Ronkali. Pastaj u lexua Ungjilli, në latinisht e greqisht, për të pohuar se asnjë gjuhë nuk është e huaj për zemrën e Anxhelos Ronkalit dhe të Karol Vojtilës. Ungjilli, që përmbyll Tetëditshin e Pashkëve, tha Papa në krye të homelisë, përqendrohet te plagët e lumnueshme të Krishtit të Ngjallur. Janë ato plagë, që Toma deshi t'i shihte me sy, e deshi edhe t'i prekte, për të besuar.

Plagët e Jezusit, komentoj Françesku, janë shkandull për fenë, por edhe vërtetim i fesë. Prandaj, vijoi, në korpin e Krishtit të ngjallur, plagët nuk zhduken, mbeten, sepse janë shenjë e përhershme e dashurisë së Zotit për ne. Këto plagë, vijoi, janë të domosdoshme për të besuar në Zotin. Jo për të besuar se Zoti ekziston, por për të besuar se Zoti është dashuri, mëshirë, besnikëri: "Shën Gjoni XXIII e Shën Gjon Pali II patën guximin t'i shikojnë plagët e Jezusit, t'i prekin duart e Tij të plagosura e kraharorin e Tij të shporuar. Nuk patën turp nga korpi i Krishtit, nuk u shkandulluan nga Ai, nga Kryqi i Tij; nuk patën frikë nga korpi i vëllait (cfr Is 58,7), sepse në çdo njeri të vuajtur panë Jezusin. Qenë dy burra të fortë, përplot me parësinë e Shpirtit Shenjt, që i dhanë botës dëshminë e mirësisë së Zotit e të mëshirës së Tij". Ishin meshtarë, ipeshkvij e papë të shekullit XX. I njohën nga afër tragjeditë, madje edhe i jetuan, tha

Papa Françesku, por nuk u mposhtën, sepse: "Më i fortë se ato, ishte Zoti; ishte më e fortë, feja në Jezu Krishtin Shpërblyes i njeriut e Zot i historisë; më e fortë se tragjeditë, ishte mëshira e Zotit, që duket në këto pesë plagë; më e fortë, afërsia amtare e Marisë".

Në këta dy burra kundrues të plagëve të Krishtit e dëshmitarë të mëshirës së Tij, shtoi, banonte shpresa e gjallë, njëherësh me gëzimin e patregueshëm e të lum:

"Shpresa dhe gëzimi, të cilin Krishti i ngjallur ua jep dishepujve të tij, gëzim që askush nuk mund t'ua marrë. Shpresë e gëzim Pashkësh, përshkuar nëpër furrën e zhveshjes, të zbrazjes, të afërsisë me mëkatarët deri në fund, deri në neverinë e hidhërinë e atij kelku. Këto janë shpresa e gëzimi, që dy shenjtorët Papë morën si dhuratë nga Zoti i ngjallur e ia dhuruan, pastaj, me duar plot, Popullit të Zotit, duke fituar mirënjohjen e tij të përvetshme". Pikërisht kjo shpresë e ky gëzim, reflektoi Ati i Shenjtë, ndjehej fort në bashkësinë e parë të Jeruzalemit. Është bashkësi, ku jetohej thelbi i Ungjillit, domethënë, dashuria, mëshira, në thjeshtësi e vëllazëri. E kjo, pohoi, është edhe figura e Kishës që pati parasysh Konkili II i Vatikanit. Shën Gjoni XXIII e Shën Gjon Pali II, tha në vijim, bashkëpunuan me Shpirtin Shenjt për ta ripërtirë e për ta rinuar Kishën, sipas fizionomisë së saj të zanafillës, fizionomi, që ia dhanë shenjtorët në shekuj: "Nuk duhet të harrojmë se janë pikërisht shenjtorët, që e çojnë përpara Kishën dhe e bëjnë të rritet. Në thirrjen e Konkilit II të Vatikanit, Gjoni XXIII dëshmoi bindjen e ëmbël ndaj Shpirti Shenjt, e la të printe e qe për Kishën, bari e udhëheqës- i udhëhequr'. Ky ishte shërbimi i madh, që i bëri Kishës: ishte Papa i bindjes ndaj Shpirtit Shenjt". Në këtë shërbim ndaj popullit të Zotit, vijoi, Gjon Pali II ishte Papa i familjes: "Kështu pati thënë ai vetë, një herë, se dëshironte të kujtohej si Papë i familjes. Më pëlqen ta nënvizoj, ndërsa po ecim në udhën drejt Sinodit mbi familjen e me familjen, një udhë që, sigurisht Ai, nga qielli, e shoqëron dhe e mbështet".

Uroj, tha në përfundim Papa Françesku, që të dy këta Shenjtorë, Barinj të Popullit të Zotit, të ndërmjetësojnë për Kishën që, gjatë këtyre dy vjetëve të udhës sinodale, t'i bindet Shpirtit Shenjt në shërbimin baritor ndaj familjes e uroj edhe që: "Të dy të na mësojnë të mos shkandullohemi nga plagët e Krishtit e të hyjmë në misterin e mëshirës hyjnore, që shpreson gjithnjë, fal gjithnjë, do gjithnjë".

*Marrë nga Radio Vatikani*



**PAPA GJON PALI II (1920- 2005)**  
**Vizita e tij historike në Shqipëri dhe Shkodër**

***“Zoti e ruajte atdheun tuaj. Zoti e mbrojte popullin shqiptar në mbarë boten. Në emër të zotit ju përqafoj dhe ju bekoj te gjithëve!”***

*(Nga fjala e Atit të Shenjtë në shqip, në tubimin madhështor para Muzeut Kombëtar, Tiranë, 25 prill 1993)*

Një nga papët më të rëndësishëm të Vatikanit, që realizoi një shërbim të pazakontë që zgjati gati 27 vjet. Karol Jozef Wojtyła, lindi më 18 maj 1920 në Wadowice, Poloni. Më 1938 ai nisi të studionte filozofi dhe letërsi në universitetin Krakovës, të cilin nazistët e mbyllën duke pushkatuar shumë vete më 1939. Në vitin 1942 u nis për në rrugën e meshtarisë dhe pas përfundimit të studimeve filozofike dhe teologjike (1942–1946), në Poloni, Wojtyła, do shugurohet meshtar, kur kishte moshën 26 vjeç. Me pas që dërguar në specializime të mëtejshme në Rome, për tu kthye në vitin 1948, në Poloni. Për një kohë shërbeu si famullitar në kisha të ndryshme, kur në vitin 1962, në moshën 38 vjeçare u zgjodh ipeshkëv ndihmës Krakovës. Ndërsa, në vitin 1964 u caktua kryeipeshkëv i Krakovës. Në vitet kur në Poloni kishte arritur kulmi e diktaturës komuniste Wojtyła, në vitin 1967 u bë kardinalë Romës, emëruar nga Papa Pali VI.

Në 16 tetor 1978, ai u zgjodh i pari Papë jo italian në 455 vite. Papa ishte kundër komunizmit, duke ndihmuar edhe në rënien e shpejtë të tij në vendet e Evropës Lindore. Ai ishte Papa që shëtiti më shumë në histori. Vizitoi 129 vende, dhe emëroi më shumë shenjtore se të gjithë paraardhësit e tij, të marrë së bashku dhe përshëndeti rreth 17 milionë besimtarë në Vatikan. Që në vitin 1980, nga Otranto e Italisë, Papa Gjon Pauli II foli për grigjën e vogël, të martirizuar nga komunistët përtej detit ( Shqipërinë).

**Më 25 prill 1993,** vizita e Papa Gjon Palit të dytë në Shqipëri do të ishte një nga momentet më të rëndësishme dhe historike për vendin tonë, pasi për herë të parë një udhëheqës shpirtëror i katolikëve në botë shkel tokën shqiptare.

Vetë Gjon Pali II e puthi këtë tokë të mbrojtur me gjakun e martirëve.



Pas zbritjes në Rinas, Ati i Shenjtë u nis drejt qytetit të Shkodrës. Në orën 10: 45 - Papa hyri në rrethin e Shkodrës, ku gjatë rrugës përzemërsisht u përshëndet nga banorë të Komunës së Bushatit e të zonave përreth. Pas kësaj, Papa Gjon Pali II-të mbërrin në Katedralen e Shkodrës, i pritur nga mijëra besimtarë katolikë e të besimeve të tjera fetare. Në orën 11: 45- Papa Gjon Pali II-të hyn në Katedrale dhe shkon para Altarit për fillimin e meshës. Pas përshëndetjes së Nuncit Apostolik, Ivan Dias, nis mesha në Katedralen e Shkodrës. Në vazhdim të meshës, Nunci apostolik i paraqiti Papës, emrat e kandidatëve për Ipeshkëv. Ati i Shenjtë i bekon ata në emër të Zotit si udhëheqës të Kishës Katolike Shqiptare. Në mesazhin e Tij, Ati i Shenjtë vuri në dukje përvojën tronditëse të kishës, në vitet e regjimit



komunist në Shqipëri. Më pas shuguroi katër ipeshkvit e rinj, Monsinjon Frano Ilia, Monsinjon Zef Simoni, Monsinjon Rrok Mirdita dhe Monsinjon Robert Ashta. Në pjesën përfundimtare të meshës, nën tingujt e muzikës kishtarë filloi kungimi. E para që u kungua nga Papa Gjon Pali II-të ishte Nënë Tereza. Ati i Shenjtë u dhuroi besimtarëve të Shkodrës dhe gjithë Shqipërisë, figurën e Zonjës së Këshillit të Mirë dhe bekoi gurin e themelit të këtij kulti, që do të rindërtohej për të tretën herë në Kalanë e Rozafatit në Shkodër. Prej kësaj Papa shkoi në Selinë Arqipeshkvore përballë Katedrales dhe nga ballkoni e saj përshëndeti gjithë besimtarët që kishin mbushur rrugët dhe sheshet e Shkodrës, njëherazi prezantoi drejtuesin e ri të Arkidieqezës së Shkodrës, Monsinjon Frano Ilia dhe ndihmësin e tij, Monsinjon Zef Simoni. Ardha e tij në Shkodër ka qenë një emocion i veçantë për popullin shkodran, për besimtarët katolikë dhe jo vetëm. Të gjithë kanë dal pa dallim feje, krahine dhe ideje për ta përshëndetur këtë misionar të paqes dhe harmonisë fetare.

Në të kthyer në mbrëmje në Tiranë, Papa mbajti një fjalim madhështor para Muzeut Kombëtar, më 25 prill, në Sheshin Skënderbej të

Tiranës, Ati i Shenjtë tha: *“Ajo që ka ngjarë në Shqipëri, të dashur vëllezër e motra, nuk ishte parë kurrë në historinë e njerëzimit... Drama juaj, shqiptarë të dashur, i intereson e duhet t'i interesojë gjithë kontinentit evropian dhe është e domosdoshme që Evropa mos t'ju harrojë. Ndërsa në gjuhen shqipe u shpreh:*

**“ZOTI E RUAJTË ATDHEUN TUAJ. ZOTI E MBROJTË POPULLIN SHQIPTAR NE MBARË BOTEN. NË EMËR TË ZOTIT JU PERQAFODHE JUBEKOJTE GJITHËVE”!**

Ai do të vazhdojë të japë mesazhe paqeje për Shqipërinë, Kosovën edhe në vitet në vazhdim. Në Pashkët e vitit 1999., në mesazhin *“Urbi et Orbi”*, Papa Gjon Pali II bën bekimin : *“I lutem Zotit të Ringjallur t'i japë dhuratën e paqes, së pari tokës së martirizuar të Kosovës, ku lot e gjak vazhdojnë të përzihen në një skenar dramatik urrejtjeje dhe dhune”.*

Papa Gjon Pali II, vdiq në moshën 84 vjeçare në Romë me 2 prill 2005.

Papa Gjon Pali i Dytë dhe Papa Gjoni i 23-të janë shpallur më 27.04.2014 shenjtorë nga Papa Françesko, në një ceremoni të ndjekur nga mijëra besimtarë në Vatikan, por edhe në mbarë botën.



**Don Lush GJERGJ**

Prishtinë

### **PAPA GJONI XXIII**

(1881 – 1963)

**Papa Gjoni XXIII (Angelo Giuseppe Roncalli, lindi 25 nëntor 1881, Provinca e Bergamos. Vdiq me 3 qershor 1963. Shërbeu si papë që nga zgjedhja e tij më 28 tetor 1958 dhe deri më 3 qershor 1963. Ishte papa i 261 i Kishës Katolike. Paraardhës i tij ishte Papa Piu XII, ndërsa pasardhësi papa Pali VI.**

*„Të duhemi mes veti, të kemi kujdes ndaj njëritjetrit në takime, që të mund të pranojmë atë që na bashkon, kështu duke shmangur atë që mund të na largojë. Me të kthyer në shtëpi përkëdhelni fëmijët tuaj dhe thuaju se kjo përkëdhelje është e Papës... Fëmijëz, nuk duhet të mendohet më në të kaluarën. Hyji e din mirë atë që ndodhi, megjithatë duhet besuar mëshirës së tij, mirësisë së tij të pafund. E juaja është vetëm e tashmja... Duhet mbrojtur shpirtin e paqes... Besoj se Zoti do t'iu përgjigjet shpresave dhe pritjeve të botës e cila ka dëshirë aq të madhe për paqe...“.* Gjoni XXIII



Të shkruhet apo flitet sot për papën Gjonin XXIII, apo siç e quanin të gjithë „Gjoni i Mirë“, është shumë vështirë, mirëpo njëkohësisht edhe e nevojshme, e dobishme, e domosdoshme, sepse ky margaritar i Kishës dhe njerëzimit të shekullit njëzet nuk guxon të harrohet, si dhe kujtimi në te nuk guxon të humbet. Me të erdhi rrezja e dritës dhe diellit, shpresës, mirësisë, dashurisë dhe vëllazërisë, hapja e Kishës ndaj gjithë botës.

Jeta e tij që e gjatë, 82 vite, pontifikati i tij i shkurtër, vetëm 5 vite, porosia e tij e amshueshme, personaliteti i tij karizmatik, gjithnjë i gjallë në Kishë dhe botë. Kështu që duke përkujtuar atë do të thotë ta ringjallësh atë, të shkruajsh për të do të thotë t'ia ofrosh atë gjeneratave të reja, sepse siç dihet, dashuria nuk vdes kurrë.

Angelo Giuseppe Roncalli, papa Gjoni XXIII, u lind në Sotto il Monte, fshat afër Bergamo-s, më 25 nëntor 1881 në një familje fshatare me shumë fëmijë si dhe varfëri të theksuar. Pikërisht aty, në rrethin familjar, mësoi artin e dashurisë, fesë, lutjes, flijimit, komunikimit me të tjerët, solidaritetin.

Prejardhje e varfër dhe e thjeshtë, mbetën karakteristika themelore të jetës së tij. Në shkollë ishte i mirë, kështu që famullitari i këshilloi prindërit e tij që t'ia mundësojnë vazhdimin e mëtutjeshëm të shkollimit.

Hyri në seminar. Mirëpo edhe aty duhej të paguante, e para nuk kishte. I ati i tij Giovanni Battista dhe nëna Maria njëherë i thanë: „Je fëmijë i fshatarëve skamnorë. Edhe nëse arrin të bëhesh

*meshtar, do të jesh gjithmonë meshtar i varfër...“*

Mirëpo, për shkollimin e tij u kujdes Provania hyjnore. Një monsinjor mori për sipër kujdesin për pagesë të seminarit. Në mësim ishte i zellshëm, kurse në jetën e përshtirterisë shumë i dalluar, me të tjerët i shoqërueshëm dhe i lumtur, gjithmonë i gëzueshëm.

I riu Angelo Giuseppe Roncalli kreu studimet filozofiko-teologjike në Begamo. Studimet posdiplomike i vazhdoi në Romë. Shërbimin ushtarak e kreu për 12 muaj. Qe shuguruar për meshtar në Romë me 10 gusht 1904, kurse Meshë e Parë kremtoi në vendlindje me 15 gusht 1904.

Ja dëshmia e tij rreth meshtarisë: „Zoti dëshiron të bëhem meshtar; për këtë më shpërbleu me mirësitë e tija, aq sa më dërgoi në Romë nën përkrahjen e Papës, zëvendësit të Jezu Krishtit, në Qytetin e Shenjtë, afër varrezave të shumë martirëve, shumë meshtarëve të shenjtë... Nuk u bëra meshatar për të qenë i nderuar, ose shkaku i përfitimit, për të jetuar më lehtë, për të jetuar e shijuar nderin dhe kënaqësinë. Runa Zot, vaj për mua po të ishte kështu! Por para së gjithash dhe vetëm për këtë u bëra meshtar, t'i bëj mirë në të gjitha mënyrat botës skamënore.“

Ishte vite të tëra sekretar i ipeshkvit të Bergamos mons. Radini-Tedeschia-s, e më pas shpirtëror në teologjinë e Bergamos.

„Themeli i apostolatit tim është jeta ime e mbrendëshme...Do i dua të rinjët sikur një nënë e



mirë“ shkruante kështu don Angelo Roncalli.

Në vitin 1921 ishte i ftuar në Romë në Kongregatën „Propaganda Fide“, sot Kongregata për „Ungjillëzimin e Popujve“, për kryetar të Zyrës për përhapjen e fesë për Itali.

Nga Roma shkruan: „Me zemër të thyer kam lëshuar Bergamon, atë që e desha: seminarin, shtëpinë studentore...Ndihëm i hedhur me tërë shpirtin tim në shërbim të ri. Këtu dëshiroj dhe duhet të rri pa mëdyshje, pa shikuar apo dashur ndonjë gjë tjetër.“

Në vitin 1925 emërohet arqipeshkëv dhe vizitator apostolik në Bullgari, shugurohet më 19 mars po të njëjtin vit. Mons. Angelo Roncalli shkruan: „Në realitet të jesh i emëruar ipeshkëv apo të mbetesh meshtar i rëndomtë, nuk do të thotë shumë për atë



shpirt i cili kërkon lavdinë e Hyjit, e jo shkëlqimin e rrejshëm të kënaqësive të kësaj bote... Jam i dëgjueshëm dhe me këtë aftësohem për t'i braktisur disa gjëra dhe për t'i pranuar tjerat“.

### Dhjetë vite në Bullgari

Menjëherë pas shugurimit ipeshkëvor shkoi në Bullgari (25 prill 1925), ku qëndroi plotë dhjetë vite. Në meshën e parë publike tha këtë: „Thjesht do të tregoj mënyrën e trajtimit të cilën do duhej në të ardhmen të kanë katolikët bullgarë ndaj ortodoksëve: këta janë vëllezërit e juaj. Nuk mjafton vetëm të kesh ndaj tyre ndjenja të përzemërta. Nëse i doni vërtet, ju jepni shembull të mirë përmes dashurisë suaj në vepër!“.

Që të dëshmoj këtë dashuri në vepër ai menjëherë filloi t'i vizitojë bashkësitë e vogla katolike në Bullgari në kufi me Greqinë dhe Turqinë. Pas vizitave tha para gazetarëve bullgarë: „Erdha këtu

që t'iu sjell katolikëve bullgarë bekimin e Atit të Shenjtë, i cili gjithnjë ka nderim të thellë dhe dashuri të përzemërt ndaj popullit bujar bullgar...Pashë një pjesë të mirë të vendit tuaj. Isha i pushtuar me thjeshtësinë dhe mirësinë e popullit i cili na pranoi gjithkund me mikpritje prekëse... Isha dëshmitar i tolerancës së plotë të popullit bullgar ndaj pakicave fetare dhe kombëtare.“

Mons. Angelo Roncalli në mënyrë të shkëlqyeshme kreu misionin e tij apostolik në Bullgari duke animuar, mbështetur dhe inkurajuar bashkësitë katolike që të jenë të bashkuara, të vetëdijshme për rolin të cilin e kanë në mesin ortodoks.

### Delegat apostolik në Turqi dhe në Greqi

Por, ja sfida e re, prapë edhe një ndërrim. Më nuk është i ri, tanimë është 53 vjeçar. Në vitin 1934 qe emëruar delegat apostolik në Turqi dhe Greqi.

Në predikimin e tij përshëndetës tha: „Pas dhjetë vitesh në Bullgari, ajo më është bërë e dashur...Kudo të jam, po edhe në skaj të botës, kur do të kaloj ndonjë bullgar pranë shtëpisë sime, do ta gjejë në dritare qiriun e ndezur. Do trokasë në derën time dhe ajo do t'i hapet, pavarësisht është ai katolik apo ortodoks. Vëlla Bullgar: mjafton vetëm ky titull për të hyrë brenda e të gjej vërtet mikpritje shumë të përzemërt në shtëpinë time...“

Turqia atëherë ishte në pozitë shumë të vështirë. Mustafa Kemal-pasha Atatürk (1881- 1938) krijoi Republikën Turke laike (1922) me kryeqytetin e Ankaras. Ai dëshiroi ta evropianizonte Turqinë, duke ndërruar Kushtetutën sipas shembullit të ligjeve italiane dhe zviceranë. Futi në përdorim alfabetin latin, kalendarin evropian, shpalli të dielën ditë pushimi dhe ditë feste në vend të premtes, ndërpreu poligaminë dhe shpalli Turqinë shtet laik me të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë qytetarët e saj.

Gjitha këto ndryshime i sollën popullatës turke vështirësi të shumta. Pas takimit të parë me këtë realitet mons. Roncalli shkruan: „Ndoshta do kam ditë të rënda e situata të vështira... Mirëpo, unë vazhdimisht shikoj në lartësi dhe në largësi...“

Në Turqi mori lajmin mbi sëmundjen, më pas edhe mbi vdekjen e të atit, Giovanni Battista. Komentoi thjesht dhe fetarisht: „Në dhimbjen time e cila është edhe më e madhe shkaku i largësisë, më ngushllon mendimi, si për të gjithë besimtarët, se do të gjendemi në qiell.“

Mons. Giuseppe Angelo Roncalli dëshiron të jetë vëlla e atë i të gjithëve, dhe për këtë përpiqet të mësimin e gjuhës turke. Disa i thonin se nuk i nevojitet, meqë bashkësia katolike lutet, kremton meshën dhe sakramentet në gjuhën frënge, me të

cilën edhe shërbeheshin. Ai iu përgjigjet: „*Po të isha unë turk, nuk do më tërhiqte feja e cila nuk e njej gjuhën time.*“ Dhe pikërisht për këtë e futi në liturgji edhe leximin e Ungjillit në gjuhën turke.

Edhe Greqia përjetonte vështirësi të mëdha në fusha të ndryshme. Mirëpo, njeriu i Zotit nuk dorëzohet askurrë, sepse në të gjitha rrethanat dhe kohërat jeton dhe dëshmon praninë dhe dashurinë e Zotit mes nesh. Mons. Roncalli në Greqi arrin vitin në vitin 1935. Së pari është dashur t'i tejkalojë dy mosbesime të mëdha: Qëndrimin e Kishës Ortodokse Greke dhe mos pajtueshmërinë e shtetit. Kushtet e jetës dhe punës për katolikët ishin shumë të rënda. Këtë gjendje menjëherë ia parashtrio mbretit Georgios II, por me pak sukses. Me kënaqësi dhe shpesh e viziton Athinën, takonte hierarkinë katolike, bënte gjithë atë që kishte mundësi.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore ai është ambasador i vërtetë i paqes, pajtimit dhe faljes.

### Diplomati i Hyjit

Pas luftës, ia edhe një sfidë e re. Në vitin 1945 Mons. Roncalli emërohet për Nunc apostolik në Francë. Edhe një herë kjo ishte treguar si hap provanial, dha tani të gjithë do e quanin „*Diplomat i Hyjit*“. Gjatë dhjetë viteve ai përfiton të gjithë me zemrën e tij të madhe, me butësinë dhe thjeshtësinë që kishte.

Papa Piu XII i jep mirënjohje dhe e emëron kardinal vitin 1952. Mons. Roncalli është i hutuar, i befasuar, i prekur, dhe në ditarin e tij do shkruante këto fjalë: „*Me të vërtetë krejt këtë e bëri Zoti, edhe atë pa mua, sepse nuk kisha mundur as të paramendoja, apo pretendoja për një mirënjohje kaq të madhe. Të jam i thjeshtë dhe përvuajtur nuk më ka krijuar problem të madh. Për çka të krenohem apo lavdërohem, O Zot imi? Merita ime është mirësia e jote...*“

### Patrik i Venedikut

Zoti tani më nuk po e le të qetë. Pas vdekjes së patrikut të Venedikut, Mons. Carlo Agostini, Roncalli emërohet në vendin e tij në vitin 1953.

Në bazilikën e Shën Markut i prezantohet besimtarëve spontanisht dhe me përvujtëri: „*Vij nga përvujtëria, isha i edukuar në varfërinë e lumtur dhe të bekuar e cila ka kërkesa aq të vogla...Provania më nxori nga fshati im i lindjes dhe bëri që të kaloj rrugëve të botës të Lindjes dhe të Perëndimit, duke u afëruar me njerëz të religjioneve dhe ideologjive të ndryshme, në ballafaqime me probleme të ashpra dhe kërcënuese të shoqërisë, mirëpo duke ruajtur qetësinë dhe barazëpeshën e kërimit dhe vlerësimit: gjithmonë kam qenë më tepër i zënë rreth asaj që na bashkon, se sa asaj që na ndan... Mirëpo,*

*para se gjithash i porositem mirësisë suaj unë njeriu i cili thjesht dëshiron të jetë vëllai juaj i dashur, i afërt, i kuptueshëm ndaj të gjithëve...*“

Mendoj dhe shpresoi se do e përfundonte këtë „*shtegtim*“ tokësor në Venedik. U përgatiste për vdekje sa më të mirë, por jo në mënyrë pasive. Vërtet ishte gjithkund vëlla dhe mik i të gjithëve, në veçanti i të varfërve dhe njerëzve të thjeshtë. Me kujdes dhe dashuri të madhe përcolli klerin e tij. Punoi, luti, meditoi, mendoj shumë, kurse me përpikëri natë e ditë shkroi ditarin e tij. Flinte pak, vetëm disa orë.

Mbi vdekjen shkroi këto fjalë: „*Mendimi mbi vdekje më bënë shoqëri të pikëlluese, por edhe të mirë, që nga dita kur u emërova për kardinal dhe patrik të Venedikut. Për mua ky mendim është i vështirë, por edhe shpëtues. Mirëpo pjesa e jetës që më ka mbetur nuk është asgjë tjetër përpos përgatitje e lumtur për vdekje.*“

Kishte zemër të madhe, ishte mikpritës i mrekullueshëm. Shpeshherë iu thoshte bashkëpunëtorëve të tij: „*Kushdo mund të më vizitoj; ndoshta dëshiron të rrëfëhet? Unë jam një meshtar i varfër; dhe po e refuzova kënd, kisha mundur ta humbas një shpirt i cili ka dashur të hapët me mua.*“

Thjeshtësia dhe mirësia e tij së shpejti përfitoi të gjithë. Venediku i ishte sikur shtëpia e tij personale e lindjes Sotto il Monte, sepse ishte komunikativ dhe mik i të gjithëve.

### Papa Gjoni XXXIII – Gjoni i mirë

Në vitin 1958 vdes papa Piu XII, i cili me vendosmëri e udhëhoqi Kishën e Hyjit për 19 vite. Kardinali Roncalli u pikëllua shumë shkaku i kësaj humbjeje të madhe, mirëpo e përjeton në heshtje, në mënyrë të krishterë, sipas motos së tij: *në dëgjueshmëri dhe në heshtje!*

Duke u nis për në Romë, në konklavë, tha: „*Gëzimi më i madh imi i cila do të mund të më ndodhë do ishte të kthehem pas disa javëve në mesin tuaj.*“ Nxori biletën kthyesë, në tavolinën e tij të punës la të hapur shumë letra të rëndësishme dhe të besueshme, duke shpresuar se do kthehej së shpejti.

Kisha, bota, po edhe kolegji i kardinalëve pritnin shumë nga konklava. Flitej se do zgjidhej një papë kalimtar. Shpesh është përmend edhe emri i kard. Roncallit, i cili tani ishte në moshën 77 vjeçare, mirëpo kishte mjaftë përvojë diplomatike dhe pastorale. Në Bullgari dhe Greqi njohu ortodoksizmin dhe sllavët, në Turqi botën islame. Qysh më herët në Propaganda Fide ishte njohur me botën misionare; në Francë takoi civilizimin dhe kulturën europiume; në Venedik udhëhoqi



suksesshëm një Kishë të vogël, por shumë të gjallë.

Nga Roma kardinali Rocalli i shkruante ipeshkëvit të Bergamos: “Shpirti forcohet me besimin e Rrëshajave të reja të cilat do mund t’i jepte Kishës Shenjte ripërtëritjen e tërësishme të Kreut dhe gjallërimin e gjymtyrëve. Nuk është me rëndësi se a është papa nga Bergamo. Lutjet e përbashkëta duhet të nxjerrin një njeri të shenjtë dhe të përkushtuar i cili me butësi dhe urtësi do të na drejtojë.”

Kardinali Angelo Giuseppe Roncalli është zgjedh papë me 28 tetor 1958. Pranoi këtë pas shumë mendimeve, pasigurisë, lutjeve, me këto fjalë: “Atë që di me varfërinë dhe vogëlinë time mjafton për të më hutuar. Mirëpo, shoh në fytyrat shembullore të vëllezërve të mi kardinal shenjtë e vullnetit të Zotit, pranoj zgjedhjen e tyre dhe uli kokën dhe krahët për barrën e kryqit dhe pirjen e kelkut të hidhet... Do të quhem Gjon. Ky emër është i ëmbël, sepse është emër i babait tim. Jemi të kënaqur, sepse është mbrojtësi i famullisë modeste ku jam pagëzuar...”

Dhe menjëherë filluan brohoritjet e ngazëllimit, entuziazmit, lotët e gëzimit të Venedikut, të Bergamos, Sotto il Monte, Parisit..., gjithë atyre që e kishin njohur. Së shpejti e quajtën “Gjoni i Mirë”. Dhe i tillë u tregua tërë jetën e tij duke i shërbye të gjithëve.

I befaso i të gjithë me shenjat dhe gjestet si dhe thjeshtësinë e sjelljeve të tija: Viziton spitalin

“Bambino Gesù” në Romë, duke biseduar për zemërsisht dhe aftësisht me fëmijët e sëmurë, me prindër, me personelin mjekësor. Më vonë vizitoi burgun “Regina Coeli”, ku mes të tjerave të burgosurve iu tha: *“Pra, ja Ne jemi këtu, bij të dashur... Erdha, më patë, i kam drejtuar sytë e mi në sy tuaj, kam vendosur zemrën time afër zemrës suaj...”*

Zemra e madhe – dashuria e papës Gjoni XXIII depërtoi edhe jashtë mureve të Vatikanit: 150 herë doli jashtë Vatikanit, duke ndërprerë kështu traditën e mëhershme shumëshekullore. Me shaka iu tha besimtarëve: “Lejoni që të dalë edhe Papa nganjëherë, sepse Papa jeton i mbyllur në dy tre hapësira. *Lejoni të vijë te ju, që t’ju ngushëllojë pak!*”

### Koncili i dytë i Vatikanit

Papa Gjoni 23, ishte gjithmonë aktuale për Kishën Katolike, për kishat e krishtera, për çdo besimtar, për çdo njeri.

Shumë menduan se ai do të ishte një Papë kalimtar. Kurse Mirëpo befasia më e madhe ishte paralajmërimi i Koncilit të Dytë të Vatikanit më 25 janar 1959. Në kuvendin e Shën Palit, afër bazilikës me emër të njëjtë, iu tha kardinalëve: „Për t’i ballafaquar problemet e sotme të njerëzve, duke qenë të frymëzuar me traditë dhe të drejtë shumë shekullore, shpallim mbajtjen e Koncilit të Përgjithshëm Ekumenik... Synim i tij nuk është vetëm për ndërtimin e popullit të krishterë, por është një ftesë edhe për bashkësitë e ndara të ndara – në kërkim të bashkimit... Këtu gjithsesi do jetë edhe Shpirti Shenjt. Unë nuk frikohem.

„Vrapi“ i Papës nuk ndalet këtu. Në ekranet televizive me bindje dhe fuqi të thellë porosiste: „Botës i nevojitet Krishti dhe Kisha duhet të jetë ajo e cila do t’ia sjellë botës Krishtin.“

Më 4 tetor 1962 Papa me tren shtegton në Loreto dhe në Assisi, një javë para fillimit të Koncilit.

Koncili Dytë i Vatikanit ishte lëvizje e madhe shpirtërore dhe fetare, ngjarje shekullore, frymëzim i Shpirti Shenjt për Kishën dhe botën. Në hapje në Sheshin e Shën Pjetrit, ishin të gjithë, mbi 200.000 mijë besimtarë, 2400 ipeshkëvij, arqipeshkvë, kardinalë, teologë, “vëllezërit e ndarë”. Gjoni i Mirë ka në zemër shumë dëshira, para së gjithave ta përditësojë Kishën – “aggiornamento”, të shërbente bashkimin e të gjithë të krishterëve, paqes në botë.

Papa Gjoni XXIII tha: “Nuk do të bëjmë ndonjë gjykim historik. Nuk do të hulumtojmë kush kishte të drejtë e kush kishte gabuar. Përgjegjësitë janë të shumta. Ne thjeshtë do të themi: të bashkohemi, t’i japin fund ndarjeve!”



Në kujdes për paqe ndërmjetëson dhe arrin sukses të shmangies së konfliktin mes SHBA dhe Bashkimit Sovjet rreth raketave ruse të vendosura në Kubë.

Sundimtarët botëror i porosiste: *"Bëni gjithçka është e mundur dhe në fuqinë e juaj për ruajtje të paqes: kështu bota do t'i shmanget tmerrit të luftës pasojat e së cilës askush nuk mund t'i parasheh... Të promovohen, përshejtohen, të pranohen negociatat në të gjitha nivelet dhe në çdo kohë, ky është rregulli i urtisë dhe maturisë, e cila fiton bekimin qiellor dhe meriton kujdesin dhe mbështetjen njerëzore..."*

Dy enciklikat e Gjonit XXIII patën kuptim shumë të madh për Kishën dhe botën: *"Mater et Magistra"* (1961) dhe *"Pacem in terris"* (1963).

Ja disa vlerësimet të rëndësishme rreth tyre. John F. Kennedy: *"Si katolik jam krenar për ato, ndërsa si amerikan kam mësuar shumë nga prej tyre..."* U Tha, Sekretari i OKB-së gjatë një fjalimi tha kështu: *"Historia njeh shumë pak personalitete të cilët kanë pasur aq shumë nderim dhe aq dashuri sikur Papa Gjoni XXIII."* François Mauriac, nobelisti për letërsisë, dëshmon: *"Papa Gjoni XXIII ka thënë fjalë të mëshirës të cilat unë gjithnjë kam dëshiruar t'i dëgjoja prej Romës, dhe i ka thënë në praninë e vëllezërve të ndarë... Për herë të parë, pas rinisë time, Shpirti dëshmohej, së paku për mua në mënyrë të dukshme"*.

Gjoni XXIII jetoi dhe punoi për gjithë botën duke dëshiruar paqe, drejtësi, nderim mes njerëzve, dashuri, bashkim. Njëherë tha: *"Enciklika Pacem in terris" është dhurata ime për Pashkë për mbarë njerëzimin. Puna me këtë nuk ka përfunduar. Deri më tani kemi përparuar mirë, mirëpo duhet guximshëm të vazhdojmë ky rrugëtim."*

#### **"Vuaj me dhembje dhe me dashuri"**

Gjoni i Mirë tani më është në moshë të shtyrë, me punë të vazhdueshme dhe me plot përgjegjësi, takime zyrtare, kujdesi për mbarë Kishën dhe për gjithë botën. Ishte ky kryqi i përditshëm të cilin e bartte. Përpos këtyre halleve ishte e pranishme edhe sëmundja, mirëpo ai, si gjithnjë ishte i gëzuar, i qetë, optimist, pranonte vullnetin e Zotit. Mjekut i cili kujdesej për shëndetin e tij i tha: *"E di se fati im është sikur i Radinit... Valixhet i kam gati për nisje."* Pas disa minutave të heshtjes dhe meditimit, vazhdoi: *"Nëse Hyji kërkon sakrificën jetësore të Papës, atëherë kjo le të shërbejë për hire të shumta të Koncilit Ekumenik, të Kishës së Shenjtë, të njerëzimit i cili kërkon paqen."*

Sekretari personal Mons. Loris Capovilla, me lot në sy ia kumtoi se gjendja shëndetësore ishte keqësuar dhe se mjekët nuk mund të bënin më asgjë.

Dhe qante. Gjoni i Mirë i tha: *"Shihe, shihe, Sekretari im, i cili duket aq i fortë, tani shqetësohet dhe qanë kur erdhi tek unë për t' më kumtuar gjerën më të bukur e cila mund t'i thuhet meshtarit: 'Sot do të shkosh në Parajsë...' E tash, ejani... Unë jam ipeshkëv, duhet të vdes sikur ipeshkëv, thjeshtë, por edhe dinjitetshëm..."*

Pas rrëfimit, vajimit të shenjtë dhe kungimit, në qetësinë më të madhe, në sigurinë e fesë, tha: *"Ja, duart e shtrira të Jezusit, ishin program i pontifikatit tim... Kërkoj falje nga të gjithë qysh nga rinia ime e deri me sot që kam pasur ndonjë mangësi Kam kërkuar, dëshiruar t'i dua të gjithë, iu kam dashur të gjithëve të mirën. Paraqes çdo vuajtje që të jenë të gjithë një: ut unum sint!... Vuaj me dhembje dhe me dashuri. Po e përcjell vdekjen time hap pas hapi. Tani me butësi drejtohem kah mbarimi... Mater mea, fiducia mea!"*

Vdiq në zë të shenjtërisë dhe shenjtërisht më 3 korrik 1963, duke u lëshuar në duar të Zotit, në Siguri të Jetës, të Ringjalljes.

Gjoni XXIII ishte i mirë, i dashur, i përvuajtur, njeri i shpirtit dhe zemrës së madhe. Jetoi kohën e tij, mirëpo atë edhe e ka tejkaluar, me fejë dhe dashuri, si profet. Pikërisht për atë jeta dhe veprat e tij mbesin të vlefshme ai, përkundrazi, ishte Papa i ndërrimeve, frymëzimeve, përtëritjeve, kthesave rrënjësore. Ai kishte zbatuar përditësimin për Kishën dhe në Kishë, kishte vizion profetik për ekumenizëm me botën e krishterë, dhe qëndrim të dialogut të hapur me të gjithë.

Për Kishën njëherë tha: *"Kisha katolike nuk është ndonjë muze arkeologjik. Ajo është burim i vjetër, i cili jep gjithnjë ujë e ri brezave të tanishëm, siç iu ka dhënë edhe atyre para nesh."*

Kurse duke bërë një përmbledhje të jetës së vet, kishte thënë kështu: *"Punuar, i shërbyem Kishës, nuk jemi ndalur duke mbledhur gurët të cilët na janë hedhur nga njëra apo ana tjetër... Dhe nuk kemi kthyer hedhjen e gurëve ndaj askujt... Një ditë Zoti, kur do të paraqitemi para tij, nuk do të na pyet a kemi bërë bashkimin, por do t'na pyet çka kemi bërë ne për bashkim... Kam nevojë për kryq. Jezusi Zot, më ndihmo ta barti me përvujtëri dhe dinjitet!"*

Papa Gjoni XXIII na ka zbuluar *"shenjat e kohës"*, kurse vet ishte dhe mbeti *"shenjë"* e kohës sonë, dhe më tepër *"shenjë"* e Zotit. Në nder të altarit është ngritur në 2000 vjetorin jubilar të krishterimit, kur Papa Gjon Pali II më 3 shtator e shpalli të Lumtur.

Dhe, ia, tash së bashku me të Lumin Gjon Pali II më 27 prill 2014 kanonizohet, shpallet edhe zyrtarisht Shën Gjoni XXIII-të, me kënaqësi, nderim, falënderim dhe dashuri të mbarë Kishës Katolike, të krishterimit, të botës mbarë.

## PAPA FRANÇESKU BASHKON NË LUTJE IZRAELITËT DHE PALESTINEZËT

*Në Vatikan me 8 qershor 2014, u mbajt një lutje e përbashkët e Atit të Shenjtë, Papa Françesku, e presidentit izraelit Shimon Peres, e presidentit palestinez Mahmoud Abbass dhe e Patriarkut të Kostandinopojës, Bartolomeu I. Lutja simbolike e përbashkët e katolikëve, myslimanëve, ortodoksëve dhe hebrenjve shënon një moment të veçantë për të gjitha fetë abrahamike.*



Kur Papa Françesku të dielën në mbremje hapi portat e Vatikanit për miqtë nga Lindja e Mesme, sigurisht që pat më shumë simbolikë imazhi i takimit sesa një përparim të vërtetë në procesin e paqes i cili ka mbetur në vend. Presidenti i Izraelit Shimos Peres dhe Presidenti i palestinezëve Mahmoud Abbass të dielën e Rrëshajave morën pjesë bashkë me Papën në një lutje të përbashkët për paqe. Ftesën e ka bërë Papa Françesku gjatë vizitës së tij të parë në Tokën e Shenjtë dy javë më parë. Ai donte t'i ftonte dy burrat e shtetit në shtëpinë e tij në Vatikan, pati thënë Papa në fund të meshës në Betlehem. Gjatë fluturimit të kthimit në Romë Papa Françesku e shpjegoi planin e tij si “një takim për lutje, i cili nuk ka të bëjë me ndërmjetësim apo me gjetjen e zgjidhjeve. Do të jetë thjesht një takim për lutje dhe më pas secili do të rikthehet në shtëpinë e vet.” “Lutja për paqe” fillimisht ishte planifikuar mbahej më parë, që gjatë vizitës së Papës në Lindjen e Mesme. Por për shkaqe organizimi ajo nuk u zhvillua, u tha pas vizitës. Takimi në këtë

moment ka megjithatë bilance politike. “Të gjithë këtu në Izrael e kuptojnë që kjo është diçka simbolike”, thotë Barak Ravid, korrespondent diplomatik i gazetës izraelite Ha'aretz. “Takimi në Vatikan është bërë i rëndësishëm jo sepse Papa ka thirrur në Vatikan Mahmud Abazin dhe Shimon Peresin, por sepse marrëdhëniet izraelito-palestineze janë në pikën e tyre më të keqe”. Në mediat izraelite ditët e fundit është spekuluar në mënyrë të përsëritur se kryeministri Benjamin Netanjahu mund të vendoste kundër vizitës në Itali. Ndërkohë kryetari i qeverisë izraelite ka dhënë bekimin e vet për vizitën në Vatikan. Por sipas disa komentuesve izraelitë, për Netanjahun ftesa “ishte shumë e vështirë të kapërdihej”. Kontaktet me udhëheqjen palestineze në Ramallah kanë ngrirë që prej ndërprerjes së bisedimeve të paqes. Netanjahu i ndërpreu bisedimet pasi Presidenti palestinez Abas lidhi një pakt pajtimi me armikun e betuar të Izraelit, Hamasin. Të hënën tek Mahmud Abas bëri betimin qeveria e re palestineze.

Shtatë vjet pas thyerjes mes Fatahut dhe Hamasit, një qeveri e pavarur nga partitë do të jetë hapi i parë praktik në rrugën e pajtimit dhe të pregatitë zgjedhjet. Ndërkohë që evropianët dhe amerikanët e kanë përshëndetur këtë zhvillim, qeveria e Izraelit e refuzon pasi ajo mbështetet nga Hamasi, një organizatë terroriste. Një takim në nivelin më të lartë politik, dhe për më tepër mes presidentit palestinez dhe atij izraelit, nuk përshtatet me moton aktuale “asnjë kontakt, asnjë negociatë”, e cila përcakton politikën qeveritare të kryeministrit Netanjahu.

Lutja për paqen, gjest profetik i Papës Françesku, në gjunjë para Zotit me një hebre, një mysliman e një ortodoks.

Lutje Zotit që të arrihet paqja në Tokën Shenjte, në Lindjen e Mesme e në mbarë botën. Lutje Hyjit të paqes, që të sjellë mbi Tokë paqen, udhën e së cilës njerëzit duket se e kanë humbur prej vitesh. Lutje për atë paqe, e cila edhe pas sa e sa bisedimesh, tryezash të rrumbullakëta e ecejakesh të pushtetarëve të kësaj bote, duket se nuk arrin kurrë. Kjo është lutja në Kopshtet e Vatikanit, në orën 19.00, ku Papa Françesku, gjatë udhëtimit në Tokën Shenjte, ftoi presidentin izraelit Shimon Peresh dhe atë palestinez, Mahmud Abas. Merr pjesë edhe Patriarku Ekumenik i Kostandinopojës, Bartolomeu I.

Luten fillimisht hebrejntë, pastaj të krishterët e më pas myslimanët. Të gjithë, në tri pjesët, që përbëjnë lutjen, fillimisht i thurin lavde Zotit për dhuratën e Krijimit e për faktin se i ka krijuar njerëzit, anëtarë të një familjeje të vetme. Më pas, në pjesën e dytë, i kërkohet falje Zotit për të gjitha rastet kur të krishterët, myslimanët e hebrejntë nuk janë sjellë si vëllezër e motra me njëri-tjetrin, si edhe i kërkohet falje Hyjit për mëkatet kundër Tij e kundër të afërmeve. Në pjesën e tretë, lutja që Zoti t'i dhurojë paqen Tokës Shenjte e t'i shndërrojë të gjithë në ndërtues të paqes. Çdo çast ndahet nga tjetri me një pauzë muzikore, për t'i lënë pastaj vendin lutjes së Papës Françesku e të dy presidentëve.

Zgjedhëm tri çaste nga kjo lutje e veçantë në Kopshtet e Vatikanit, në një lëndinë të bleruar, që sheh drejt Kupolës së Bazilikës së Shën Pjetrit, vend i përshtatshëm për ta ndjerë veten pranë Hyjit të Gjithëpushtetshëm e për ta lënë Shpirtin Shenjt, në ditën e Rrëshajëve, të prekë zemrat e të pranishmëve, por edhe të të gjithë njerëzve, që anekënd botës janë bashkuar me këtë grup të vogël, që lutet në Vatikan.

#### Ja lutja e hebrejve:

“O Zot, na jep paqen, mirësinë, bekimin, hirin, dashurinë, respektin dhe mëshirën në, gjithë popullit të Izraelit dhe gjithë botës. Na beko të gjithëve me dritën e Fytyrës tënde, o Ati ynë. Sepse me dritën e Fytyrës Tënde, Ti na ke dhënë o Zot, Hyji ynë, Torahun e Jetës, dashuri e respekt, ndershmëri e bekime dhe

jetë e paqe. Qoftë vullneti yt që të na bekosh të gjithëve me Paqen Tënde”.

#### Të krishterët zgjedhën një lutje të Shën Françeskut të Asizit:

“O Zot, më bëj mjet të Paqes tënde:

*Ku ka urrejtje, bëj që unë të çoj Dashurinë.*

*Ku ka fyerje, të çoj Faljen.*

*Ku ka mosmarrëveshje, të çoj Bashkimin.*

*Ku ka dyshime, të çoj Fenë.*

*Ku ka gabime, të çoj të Vërtetën.*

*Ku ka dëshpërim, të çoj Shpresën.*

*Ku ka trishtim, të çoj Gëzimin.*

*Ku ka errësirë, të çoj Dritën.*

*O Mësues, bëj që unë të mos kërkoj aq:*

*Të ngushëllohem, se sa të ngushëlloj.*

*Të kuptohem, se sa të kuptoj.*

*Të duhem, se sa të dua.*

*Sepse*

*Duke dhënë, merr;*

*Duke falur, falesh;*

*Duke vdekur, ringjallesh për Jetën e Amshuar”.*

#### E ja tani, lutja e myslimanëve për paqen:

“Lavdi Zotit të mëshirshëm, të dhembshur, mbret, shenjt, paqësor, besnik, sovran, i çmuar, i fuqishëm, madhështor, krijues, ideator, formues.

O Zot, Ti je paqe, e paqja vjen prej Teje dhe tek Ti paqja kthehet. Ti je i bekuar e Ti je i lavdishëm, O Zot i shkëlqimit dhe i nderit, na frymëzo, o Zot, me paqe e na zbulo paqen e na bëj banorë të mbretërisë së paqes, ndër ata, që nuk jetojnë me frikë e dhimbje.

O Zot, kërkojmë strehim tek Ti nga padrejtësia e shtypja, nga sulmi i paligjshëm, e ne të kërkojmë, o Zoti ynë, të na udhëheqësh në udhën e drejtë, që të mos humbim e të mos biem, duke besuar në Ty e duke e lëshuar veten në duart e Tua. Na udhëhiq o Zot drejt fjalëve më të përshtatshme, na udhëhiq o Zot drejt veprave më të përsosura, na udhëhiq o Zot drejt një morali më të mirë, sepse askush përveç teje nuk mund të na udhëheqë e Ti je i aftë për gjithë këto gjëra.

O Hyj, na bëj o Zot të prirur për gjithçka është e mirë, kundër gjithçkaje të keqe, të lutemi të na tregosh gjithçka është e mirë dhe e drejtë. Na dhuro o Zot siguri, paqe, qetësi dhe fe, për ne e për njerëzit tanë, për familjet tona, për baballarët e nënat tona, për bijtë e bijat tona, e për të gjithë njerëzimin e të gjitha kombet, për të gjitha krijesat e krijuara madhërisht prej Teje. Na dhuro o Zot të mirën, në këtë botë e në tjetrën e na mbro nga mundimet e flakëve [të Ferrit].

O Zot, na sill paqen në tokën e paqes, o Zoti i shkëlqimit dhe i nderit, zhduke padrejtësinë nga të shtypurit e kësaj toke, ushqeje popullin tënd, që ka uri, e mbroje nga frika, mbaje larg nga e keqja e nga ata që bëjnë të këqija, nga agresorët e padrejtë, o Zot i Botëve”.





### Takimi në Vatikan dhe shpresat për një të ardhme

Pas këtyre tri etapave të lutjes në Kopshtet e Vatikanit, lutja e Papës Françesku dhe e dy presidentëve, atij izraelit, pra hebre e, atij palestinez, pra, mysliman, ndërsa dielli perëndon e Zotit të gjithëpushtetshëm i lartohen nderime e lavdi, me shpresën që Hyji i paqes të dëgjojë lutjen e përgjëruar për paqe në tokën ku lindi, jetoi, vdiq e u ringjall Biri i Tij, për shëlbim të gjithë njerëzimit.

Megjithatë takimi mbetet natyrisht para së gjithash një akt simbolik. Të enjten e javës së ardhshme në Izrael mbahen zgjedhje presidenciale dhe 90-vjeçari Peres nuk kandidon më. Për Shimon Peres “takimi për lutje” do të jetë një nga paraqitjen e të të fundit të mëdha në publik para zgjedhjeve. Në rrugët e Jeruzalemit perëndimor takimi në Vatikan nuk është temë e rëndësishme. “Do të jetë me siguri një takim i përzemërt, do të thuhet gjëra të cilat janë të rëndësishme për të dyja palët, dhe aq”, thotë një djalë i ri. Një ushtar i ri besimtar e refuzon takimin. “Abu Mazen Abas përfaqëson një sistem që urren Izraelin. Ne nuk kemi asnjë interes të marrim pjesë”.

Edhe në Ramallah në Jordanin perëndimor, rreth 45 minuta larg me makinë dhe ndarë nga një pikë kontrolli me Jeruzalemin, ftesa në Romë nuk ngjall shpresa të mëdha. Këtu njerëzit janë të zënë me qeverinë e re kalimtare dhe çështjen e pasigurte të vënies në jetë të pajtimit mes Hamasit dhe Fatahut. “E çfarë mund të bëjë Peres?”, thotë Bassem, një kalimtar në qendrën e Ramallahut. “Ai është vërtet Presidenti i Izraelit, por është Netanjahu me qeverinë e tij të djathtë që vendosin. Pa miratimin e tyre nuk ndodh

asgjë”. Një tjetër kalimtare sheh para së gjithash të rëndësishëm dialogun mes feve: “Papa është një njeri i fesë dhe paqes. Ai është shembull për botën e krishterë dhe myslimane”, thotë Khitam Deek. “Pikërisht tani kur Izraeli po na ndëshkon sërish me sanksione ekonomike për shkak të qeverisë sonë, ndoshta ai mund të luajë një rol të rëndësishëm”. Këto ditë në Ramallah çdo mbështetje nga bashkësia ndërkombëtare është e mirëpritur. Edhe vizita e Papës dy javë më parë në Betlehem, vendlindjen e Jezusit në Jordanin perëndimor, sot të pushtuar nga izraelitët, u dha krahë palestinezëve. Veçanërisht pamjet nga ndalesa e papritur e Papës në murin ndarës të ngritur nga izraelitët, u bën përshtypje shumë njerëzve. Gjatë rrugës për në meshën në Betlehem Papa kishte zbritur nga makina e tij dhe kishte kaluar disa minuta në lutje të heshtur pranë murit. Për izraelitët muri ndarës shërben si mbrojtje nga terrorizmi. Për palestinezët ai do të thotë kufizim masiv i lirisë së tyre të lëvizjes.

Takimi në Romë është vazhdimi i dialogut dhe angazhimit të Vatikanit në rajon, u tha nga burime zyrtare në Ramallah. “Krahas gjithë peshës simbolike, takimi për ne është edhe një konfirmim i rolit të Selisë së Shenjtë këtu në vend”, thotë zëdhënësi i PLO Xavier Abu Eid. “Ata thonë me këtë se mund të mbështetemi tek ata, se përpiqen të ndihmojnë ku mundin për të arritur paqen në një rajon që për Vatikanin dhe të krishterët në gjithë botën është i rëndësishëm”. Në të njëjtën kohë takimi forcon edhe marrëdhëniet dypalëshe mes palestinezëve dhe Vatikanit. Një element i rëndësishëm ky në rrugën e gjatë drejt një shteti palestinez.

**Don Nosh Gjolaj, SDB**  
Podgoricë

## **Faktorët që e shkatërrojnë bashkësinë martesore- familjen** *(Pjesa e fundit)*



### **4. Mendjelehtësia si dhe kryelartësia janë gabimet fëmijërore apo naive**

Mendjelehtësia si dhe kryelartësia nuk janë asgjë tjetër përveç pasqyra e individit nëpër mes të cilit shprehet personi ende me mendësinë e fëmijës. Një sjellje e tillë lajmërohet pak a shumë në veshmbathje, në modë, në elegancë. Një pamje e tillë sigurisht është që nga koha e lashtë e paleolitikët, siç është mënyra e veshjes për t'u dalluar nga ai tjetri, si fjala vjen, ai ose ajo, është veshur me lëkuren e ariut, për t'u dalluar nga të tjerët. Sot mjetet e informimit e shfrytëzojnë prirjet e njeriut të sotëm për propagandën konsumuese deri në skaj. Sepse, ai jo vetëm se dëshiron për t'i pëlqyer tjetrit, për t'u treguar, por edhe për t'u dalluar, se unë jam dikush (tregoj statusin shoqëror), që eci me hapat e modës, e ashtu jam në vëmendje e mjedisit. Kuptohet se sjelljet e tilla u sjellin bizneseve fitimet e mëdha, posaçërisht firmave e llojllojshme, të cila i shfrytëzojnë jo

vetëm shtypin e ditës, revistat, radion, televizorin internetit por edhe çdo mjet tjetër, qoftë informimit qoftë i reklamës.

Njeriu i sotëm me bindjet e këtilla, i ka ndërruar nocionin të “jesh dikush” ai është bërë për t'u “pëlqyer dikujt”. Në këtë ka të bëjë edhe diçka me narcizmin, që i jep njeriut vlerën e ngritë nga bota e pa vlershëm e tij.

Prej kah buron ky mentalitet fëmijëror? Pse nuk është e mundshëm për ta eliminuar nevojat naive?

Në rendin e parë është jo stabiliteti, që e shoqëron njeriun gjatë tërë jetës, dhe si e tillë bëhet aleancë edhe mendjelehtësia e individit. Akthi apo frika që të tjerët nuk do të na pranojë, ose do të jemi teje pak të çmueshëm. Mendjelehtësia buron nga kompleksi apo frustrimi i brendshëm, duke menduar se në syrin e tjetri jem më të pavlefshëm, siç jemi në të vërtetë. Frika që nuk jemi të aftë për t'u treguar pasurinë e brendshme e imponon njeriun për ta treguar shkëlqimin e jashtëm.

I njohim disa tipa të mendjelehtësisë, që nga

natyra janë të pafajshme, siç fjala vjen, disa dëshirojnë të fotografohen edhe të jenë në çdo fotografi të pranishëm, edhe ata në qendër të grupit ose afër atij, që diçka vlen, për t'u lëvduar më vonë, se me çfarë personave, ai është takuar, që ishin në atë kohë të lavdishëm, e të njohur si për shembull persona politik, ose yje e filmit apo të sportit etj.. po qe se dikush në këtë pa ndërpre lëvdohet e krenohet, aty është kompleksi apo frustrimi i brendshëm ose zbrazëtia e zemrës.

Kemi edhe tjera mënyra, se si shprehet mendjelehtësia, për shembull në punë, në martesë, në situatë ose për heroizëm. Është atëherë kur dëshirojmë përpara të tjerëve të tregohemi si tip guximtar duke nxitur edhe tjerët në këtë hapë.

Mendjelehtësia edhe pse është lëshim i vogël ajo mund të shpie deri te humbje të mëdha, e bëhet por si sirena që magjepsë e njëherë të asgjëson. Sa ka fitoren e dashurisë të cilat dukeshin të rëndësishëm, që ishin nga mendjelehtësia. Fatkeqësisht e zbulojmë atëherë kur është tepër vonë. As meshtari që e thotë meshën nuk është i kursyer prej mendjelehtësisë. Janë momentet që në pamjet subjektive nëpër mes rolit që e kryen krejtësisht shkrihen dhe behën një, duke e ngritur në lartësi e larta të krenarisë përpara tjerëve. E kam stilin e jetës, e kam veshmbathjen, e kam trupin, i kam njerëzit dhe e kryejnë detyrën, e luaj rolin që para tjerëve jam krenar. Mund të jam ipeshkëv ose klerik, kolonel apo rreshter, sekretar i shtetit apo zyrtar i thjeshtë, në fund edhe unë jam pjesë e teatrit të madh, që i themi jeta e përditshme. Kjo dëshirë sipas qejfit mund të më asgjësojë. Krenaria e tillë thajse i përngjan drogës, jo vetëm se tenton individin në çfarëdo mënyre për t'i pëlqyer por ia rrëmben aftësitë për t'u kundërvu këtij tundimit, i cili na sjellë një farë kënaqësie por në anën tjetër ta rrëmben lirinë, dhe si i tillë individ nuk është i aftë për t'i zgjedh problemet e jetës. Asnjë lëshim tjetër apo gabim nuk ka aq shumë dimensionin social, siç e ka mendjelehtësia apo krenaria, sepse gabimi i tillë nuk mund të mbesin në vetmi, sepse të tjerët e pohojnë e ndikojnë në zhvillimin e saj. Peshkatarët që kishin sukses të mirë në peshkim, gjahtarët që marrin trofetë, adhuresi që pasionohet në partneren e vet të zgjedhur, nuk kënaqën aq për suksesin e vet, por është më tepër në prapavijë kënaqësia që pëson, që do të bisedojnë për ngjarjet e tilla edhe më tutje ndoshta për të jetën e tyre.

Sipas La Rockefaucauldës: “virtyti nuk do të ecte aq gjatë rrugës po qe se nuk e shoqëron mendjelehtësia apo krenaria”. Që nuk është asgjë

tjetër përveç narcizmi, i cili i këndon lëvdatat vetes e mëkatet e moralistëve, po ashtu është rasti i volitshme për angazhimin e mëtejshëm, e gjestet e tillë kuptohet edhe e motivojnë personin në fjalë. Për këtë mendjelehtësia apo krenaria që është e drejtuar ka e mira mund të kthehet edhe në virtyt (sipas C. Castellata, Leksikoni i ndjenjave).

#### 5. “Pikërisht je si nëna apo si baba në vend!”

Çifti i ri, prej kohës në kohë ballafaqohet me prindit, qofshin të burri, qofshin të gruas, sepse janë personat me të cilët janë rritë, frymëzuar, formuar, si individ ashtu ata e kanë pasur ndikimin e madh në fëmijën e vet.

Nuk është lehtë të rregullohen raportet mes nënës e babës, që do të jenë të barabartë dhe të nevojshme për dy palët, për këtë kërkohet jo vetëm mençuri por edhe bisedë të përbashkët - dialogun, qofshin ato në rrafshin e të drejtave, që fëmija i rregullojnë mënyrën e jetës, që do të jenë për ata të pranueshme dhe njëherë prindit nuk i përjashton.

Në mes partnerëve menjëherë lajmërohet raporti i quajtur klishe apo stereotip, të cilën e bartin që nga gjiri familjar. Në mënyrë të pavetëdijshëm ndikon në fëmijë sjellja e prindit, qoftë ajo e mimikës, qoftë ajo e shprehjeve, qoftë ajo e vetive si të mirave ashtu edhe të këqijave, vulosen në shpirtin e fëmijës, që aktualizohen apo realizohen posaçërisht gjatë bashkësisë martesore. Zakonisht të fejuarit apo të dashëruarit përpara martesës apo gjatë fejesës ata nuk kanë kohë të mjaftueshme për t'u njohur me gjitha mungesat e dobësitë e të kaluarës, si për njërin ashtu për tjetrin palë, posaçërisht stereotipat apo klishetë që e bartin nga gjiri familjar.

Zakonisht prindi i afron fëmijës përvojat e martesës, por në rastet e shumta ai është modeli negativ, në anën tjetër fëmija vetëm i imiton prindin edhe sa i përket stilit martesor. Për shembull stili predikues, që nuk është asgjë tjetër përveç fjalët e shumta për ta bindur atë tjetrin. Ndër tjera edhe kjo është një prej vetive apo shprehjeve, që nuk është asgjë tjetër përveç fryti i edukimit, po ashtu edhe sulmi ndaj partnerit, po qe se nuk akordohen mes vetes për ndonjë veprim apo mendim.

Hollësisht mund ta përshkruajmë situatën apo t'i paraqesim të gjitha dëshirat që dëshirojmë për t'i realizuar në gjirin e martesës, por shtegdalja nga kjo rrugë e qorret është në çfarë themelit dhe të cilat mjetet do t'i përdorin çifti për ta realizuar rrugën e përbashkët në gjirin e martesës.

Zakonisht gjatë një rrugët të përbashkët në gjirin e martesës raportet mes tyre dita-ditës janë më të



qarta e më të kuptueshme. Një ndër mundësi është për t'u ballafaquar me stilet e llojllojshme të jetës, dhe si kusht i parë, është zhveshja nga paragjykimet, nga shpjegimet e shëmtuara apo gjysmake, nga fjalët e shumta për ta bindur atë tjetrin, atëherë mund të rrimë së bashku pran tryezës e së bashku vendosim për planin e përbashkët apo për ndonjë problem të pazgjedhur. Po ashtu mund të ndodhin që çifti martesor i shtron në tryezë të gjitha mundësit apo nuancat e ndonjë problemit të pazgjedhur apo ndonjë propozimit, por u mungon ndoshta definicioni i qartë ose e përjashtojnë njëra-tjetrën. Por, gjithherë e kurdoherë është e rëndësishme gatishmëria në mesin e partnerëve për t'u korrigjuar, që nuk është asgjë tjetër përveç detyra e shenjtë gatishmëria e përhershme për korrigjimin e vetvetes, mendimit, duke ndryshuar edhe këndvështrimin apo pikëpamjet që i kemi ndaj problemit apo propozimit, sepse kjo është ajo rruga e cila na mundëson zgjedhjen adekuate, sepse partnerët mësojnë njëri prej tjetrit, sepse ata gjinden në situatën e re e jo në gjirin e dikurshëm familjar. Kjo rrugë u mundëson jo vetëm për t'u shkund nga klishtë apo stereotipat e të trashëguara por edhe për zgjedhjen e suksesshme çfarëdo problemit apo stilit të jetës që dëshirojnë së bashku për ta realizuar.

Individi, i cili dëshiron ta krijojë mënyrën dhe stilin e jetës, ai duhet ta ketë edhe identitetin e formuar përpara martesës, sepse njeriu si i tillë përpos identiteti e bartë me veten edhe shumë shprehje apo veti të cilat ndërlidhen ngushtë me mjedisin në të cilin ka jetuar, me mendësinë e rrethit dhe e ndjekin porsia hja të cilën nuk mund ta kapërcej, sepse ato nuk janë asgjë tjetër përveç klishtë psikologjike, që janë vulosur në formimin e tij personal që nga lindja deri në formimin e identitetit të tij. Personi si i tillë, i bartë me vete edhe pse fare nuk është i vetëdijshëm për këto modele. Fjala është për bagazhin që e ka pranuar nga kultura e mjedisit, nga qytetërimi, nga tradita, kultura, nga pozita sociale, nga religjioni apo pikëpamjet etikomorale, edhe sa e sa të tjera, të cilat i ka pranuar qoftë vullnetarisht qoftë në mënyrë tërthorazi etj. E kularja e shoqëron individin siç, e shoqëron edhe hja, e cila vigjilon në vendimet apo përcaktimet e tij, por zakonisht nuk lejon që të depërtojnë rrezet e diellit. Në rastet e shumta çifti martesor shikon e vlerëson nëpër mes kësaj pritmes apo kënd shikimit, ata çka kanë

vërejtur e kanë përjetuar në gjirin familjar kur ende ishin fëmijë, pikërisht nga prindit e tyre. Në mënyrë të vetëdijshëm por ndoshta nganjëherë edhe pavetëdijshëm qëndrojnë në pozitat e imitimit, që nuk është asgjë tjetër përveç në mënyrë të verbët imitohen prindi. Shpeshherë ndodh se sjelljet, përgjigja, mimika, janë vetëm imitimi i plotë i prindit. Jeta e përbashkët në këtë rast është në rrugën e qorret, e cila nuk ka shtegdalje. Partnerët që nuk mundohen për ta ndërtuar jetën e vet specifike në themelet tjera ose së pakut korrigjimin e disa sjellëve, ata shkojnë nga greminë e pa kthim. Kuptohet vetvetiu se më lehtë është ta pranosh ata që je i mësuar, që është mishëruar si shprehi se sa të krijosh mendësinë e re, shprehitë e reja. Nganjëherë mashtrohet çifti i ri, se sjelljet e tilla nuk na sjellë probleme, por mbetet në nivelin e fëmijës, apo në atë situatë që nuk kërkon orvatje të brendshme, as nuk tenton për t'i korrigjuar stereotipin apo kilëshet e marruar nga trashëgimia. Kuptohet te çifti që nuk vetëdijësohet për t'u korrigjuar dhe për t'u krijuar jetën dhe stilin tënd specifik i hakmerret herët apo vonë, që nuk i sjellë asgjë të mirë përveç vdekjes së dashurisë.

Me tjera fjalë mund të themi me gojë plot, në çiftin e tillë ende jeton prindit i tyre ose është dora e gjatuar e prindërve, e prindit vazhdojnë jetën nëpër mes fëmijëve. Bile edhe më tepër, disa veti apo shprehi që i kemi marrë nga prindit si bie fjala stilin e jetës apo ndonjë shprehi tjetër, ia imponojnë edhe çiftit martesor, e në rastet e shumta ato sjellin jo vetëm moskuptim por frenime psikike apo psikologjike.

Përderisa vulën dhe klishtë që i trashëgojmë nga gjiri familjar mund t'i shfrytëzojmë në mënyrë tjetër, për shembull, përvojat e prindit për t'i zgjedhur problemet konkretet në mesin e ri familjar, jo kopjim por mënyra se si tejkalohe apo ballafaqohet me problemin konkret. Siç thotë



proverbi i vjetër: “Historia është mësuesja e jetës!” Biseda apo dialogu me bashkë partnerin, jo vetëm se do ta qartësojnë mospajtimin në të cilën edhe vjen herë pas herët konflikti, por iu mundëson për t'u ballafaquar e për ta zbuluar shkaqet e vërteta. Ata atëherë janë në rrugën e cila iu mundëson për t'u çelur apo hapur edhe bashkësisë së gjerë, në të cilën edhe personaliteti i tyre jetësohet edhe më tepër.

## 6. Dy hapa deri te fati dhe lumturia

Mund të themi, kënaqësia të cilën e përjeton vet individi, është në veten e personit, i cili di ta përjetojë veten dhe tjetrin. Po qe se vendosim për çfarë veprimi dhe atë e bëjmë me zemër, kuptohet aty nuk mungon edhe kënaqësia e brendshme. Po ashtu është e vërtetë se fati dhe lumturia nuk na tërheq, po qe se nuk është së pakut e realizueshme, e vetëdijshme dhe e lirë.

Përpare se ta vazhdojmë një shpjegim të shkurtër për çështjen, të cilën të gjithë e kuptojmë, në të cilën është fati si edhe lumturia më e madhe, që mund ta përjetojmë në këtë tokë. Me siguri është sipas hulumtimit e bëra deri më tani përvojat e të dashuruarve dhe përvojat e dashurisë së parë. Në brendinë tonë shpërthen papritmas një gufimi i këndshëm, i kënaqësisë, të cilën nuk mund ta krahasosh me përvojat e të kaluarës dhe as atëherë kur kënaqësia arrin kulmoren e saj dhe ndalet. Siç shprehet Goethe: “Ndal për një moment tepes je i bukur!” Është momenti në të cilën zhduken të gjitha brengat, vështirësitë dhe mungesat njerëzore. Deri në këtë përjetim arritet vetëm atëherë po qe se edhe tjetri person është i dashuruar, jo vetëm njëra palë por të dy palët. Po qe se ata sjellën vetëm për vete për ta shfrytëzuar njëri-tjetrin, për ta shfryrë impulsin seksual, atëherë ata i ngushton frika ose mëshira. Fati apo lumturia e jonë është e varur prej thjeshtësisë e natyrshmërisë që rrjedhë vetveti në mënyrë spontane. Po ashtu nuk është e mjaftueshme, ai që është i dashur, por duhet të jetë i thjeshtë dhe për këtë thjeshtësi e spontanitet të natyrshme ai ja rikthejnë dashurinë që e ka marr nga ai tjetri.

Ky shembull e ndriçon shumë gjëra, se fati ose lumturia e jonë e plotë, nuk është e varur vetëm prej neve. Dashuria ime është hapja dhe ftesa personit që e dua. Po qe se ky person nuk përgjigjet jam i humbur. Për këtë është e rëndësishme hapja dhe ftesa dhe njëherë edhe nevoja për përgjigje. Të gjitha këto mund të ndodhin të njëjtën kohë, në mënyrë spontane e të natyrshme, ashtu siç dëshirojmë. Që do të thotë, që dashuria ime, e cila

pret dhe rrezikon dhe në të cilin e pres edhe përgjigjen. Fati lumturia është po ashtu e lidhur më shumë të paqarta, të panjohura, shumë pyetje në të cilin ndoshta do t'i marrim përgjigjet, sepse ai tjetri është krejtësisht i lirë dhe i thjeshtë menjë fjalë i paparaparë. Sa larg është kjo bindje nga ëndrrat! Në jetën e përditshme është fati gjithëherë i papritur, sepse nuk ka ndonjë themel të fortë, lehtë na rrëshqet nga dora, sepse di të jetë e lirë dhe jo kërkuese. Vërtetë i përngjanë njeriut, i cili kërkon kënaqësi por këtë nuk mund ta përjetojnë përpara, sepse ajo vjen si dhuratë, si mrekulli që i qeshet.

Për këtë duhet njeriu pa marrë parasysh pozitën, profesionin, vendin ta kërkojë kënaqësinë për të cilën kërkon shumë guxim dhe orvatje. Sepse situata në të cilën gjendet njeriu, mund të rikthehet në kënaqësi, edhe pse në fillim na duket e pamundshme apo e vështirë. Por gjithçka varet prej vet njeriut apo personit. Më së parit duhesh të jesh si ora e diellit, që vet kthjellet dhe numëron orët e bukura të diellit përderisa ato të vranëtat nuk i numëron.

Ja një shembull: Një pasanik amerikan, i cili ishte i brengosur dhe i tmerruar sepse gjithë pasurin që e kishte pasur e kishte humbur thuajse për krye nate, jo vetëm aq por kishte mbetur edhe boç. Tani iu sjellshin nëpër kokën e tij vetëvrasja, i dëshpëruar krejtësisht. Ashtu i tretur pa shpresë në jetë duke bredhur rrugëve të qytetit të New Yorku në Avenynë e pestë, dhe në një udhëkryq papritmas ballafaqohet me një njeri tjetër, i cili ishte me dy shtaga nën sqetull, sepse nuk i kishte asnjërin këmbë. Papritmas e shikoi invalidin, këtë e vërejtë dhe pas disa sekonda edhe tha: “Mirdita, ditë të bukur e kemi sot, a nuk është ashtu zotëri?” Papritmas shndriti një rreze shprese në zemrën time, dhe them me vete: “sa i pasur qenka ky njeri! Unë i ri: po, me dy këmbë e dy duar: po, trupin e shëndoshë, mund të eci, të punojë, çka më mungon? U skuqa nga vetvetja. Po qe se ai, pa këmbë është i fatlumë, i kënaqur përderisa unë i shëndoshë pse atëherë ia krijoj vetes ferrin. E ndjeva veten për një moment të lehtë, të freskuar dhe prej brendisë u zhduken të gjitha vështirësitë, brengat e retë e zezë. Vazhdova rrugën jo vetëm i kënaqur por edhe i fatlum!”

Çdo njeri duhet ta përjetojë udhëkryqin e tillë, jo vetëm vlen çdo njeri, por edhe për çdo çift martesor. Çdo njeri, çdo individ e bartë me veten çelësin jo vetëm të kënaqësisë, por edhe të fati, lumturisë, të dashurisë, pa marrë parasysh se sa është kryqi apo barra e jetës e rënd!



**Dom Nikë Ukgjini**  
Shkodër

**KISHA KATOLIKE DHE SFIDAT  
NË MBRETËRIN E ZOGUT  
DHE SISTEMIN KOMUNIST  
(Pjesa e dytë)**

**Kisha katolike dhe pushtimet (1939-1944)**

Me largimin e Zogut nga Shqipëria më 1939, me ardhjen e qeverisë fashiste dhe asaj naziste, Kisha Katolike në Shqipëri edhe përkundej peripecive që pati gjatë sistemit mbretërorë, akoma gëzonte një përkrahje të konsiderueshme në popull në krahësim me dy bashkësitë të tjera fetare.

Komunitetet fetare kombëtare, pushtimin italian, me 7 prilli 1939, në mënyrë entuziazëm të ndryshëm priten dhe njohën rendin e ri shtetëror. Kisha Katolike, natyrshëm mbështeti më shumë pushtimin Italian dhe lidhjet e ngushta që u krijuan me Italinë dhe Vatikanin.

Kleri katolik nuk ishte i pakënaqur, duke qenë i vetëdijshëm se Shqipëria kishte nevojën e përkrahjes nga një shtet i fuqishëm. Dhe Italia katolike ishte protektori më i mirë, me kusht që të respektohej pavarësia.

Imzot Gaspër Thaçi, Atë Gjergj Fishta, Atë Anton Harapi, Atë Pal Dodaj, Dom Lazër Shantoja, Ernest Koliqi, Mustafa Kruja etj, e kuptonin se në momentet e pushtimit, detyrë kryesore ishte ruajtja e pavarësisë së Shqipërisë, ruajtja e flamurit kombëtar, shkollave dhe gjuhës shqipe, administratës shqiptare shtetërore, civile e ushtarake. Kleri katolik ishte nostalgjik ndaj pavarësisë së humbur, por ishin më të kënaqur me një autonomi të kufizuar se sa me një Shqipëri të shkatërruar ekonomikisht e të qeverisur keq siç ishte ajo e kohen e Mbretit Zog. Po, të njëjtin mendim, shprehte dhe delegati apostolik Leone Nigris, i cili më 28 maj 1939, do shkruante Guvernatorit, Jacomonit, ku ndër të tjera kishte kërkuar disa garanci për të ardhmen e Shqipërisë: respektimin e autonomisë, heqja dorë nga depërtimi i fashizmit në Shqipëri etj..

Thaçi, Fishta, Harapi etj., kanë bërë pjesë në grupimin intelektual pro evropian shqiptar, që shpëtimin e vendit, për të cilin kanë punuar tërë jetën, e kanë parë në kulturën perëndimore. Shumica prej tyre kishin qenë kundërshtarë të regjimit të vendosur nga Mbreti Zog dhe largimin e tij nga pushteti e shihnin si shpëtimtar për Shqipërinë, ndërsa Italinë, si një mjet për të realizuar këtë synim. Afërmendsh, ato e kishin të qartë, se forca e Shqipërisë ishte e atillë, që e vetme nuk mund të garantonte dot as mbrojtjen dhe as integritetin e shtetit të vet. Në këto rrethana të vështira dhe pa rrugëdalje tjetër, mund të



parashikonin, se ndërsa italianët do të kishin pushtetin, ato do të përpiqeshin të manovronin, ose së paku ta drejtonin nga interesat e Shqipërisë

Edhe pse të dy pushtuesit kishin premtuar Shqipërinë etnike dhe përfshirjen e Kryedioqezes së Tivarit dhe Shkup-Prizrenit brenda Kishës së Shqipërisë, studiuesi, Markus Peters do thoshte se “prirja që mbisundonte të krerët fetar shqiptarë ishte me fjale të tjera ajo e një “Wait and see” plotë ankth, më tepër se prirja për të qenë protagonistë politik”.

Faktet dhe rrjedhat e ngjarjeve treguan se besimi, përpjekja dhe marrëveshja e tyre ishte e kotë dhe zhgënjimi i tyre që i pashmangshëm më Italianet qoftë edhe më Gjermanët, të cilët këta të fundit pushtuan Shqipërinë në 9 shtator të vitit 1943. Përndryshe, zërat më të theksuar të Regjencës shqiptare ishin, Atë Anton Harapi dhe më vonë edhe Dom Lazer Shantoja.

Këta klerik si dhe Atë Gjon Shllaku, Dom Lek Sirdani, Dom Ndre Zadeja, Atë Mark Harapi, në fjalimet e tyre paralajmëronin së shpejti do vij një



stuhi e zezë e cila shkatërron mbarë Shqipërinë. Atë Anton Harapi në një letër dërguar Arqipeshkvit të Shkodrës Garpër Thaçit, në vitin 1943, nder të tjera shkruante: “Nuk po mundem t’ endem fort, pse komunistët po me ndjekin për gjurmë.

### Regjimi enverist

Pas, largimit të gjermanëve nga Shkodra më 28 nëntor 1944, ardhja e regjimit enverist në dhjetor 1945, minoriteti katolik në pjesën më të madhe, për arsye ideologjike, materiale dhe politike nuk dëshironte të bashkëpunonte me qeverinë diktatoriale. Për këtë arsye Kisha Katolike, u akuzua për komplot kundër qeverisë, dhe u morë në shënjestër, duke e rritur pakënaqësinë e popullsisë së Shqipërisë së Veriut ndaj saj. Përkeqësimi do shkonte deri në atë masë sa që klerët katolikë u cilësuan si “bashkëpunëtorë” me shërbimet e vendeve të huaja. Ky konstatim i tyre i jepte të drejtën Frontin Demokratik të drejtuar nga Partia Komuniste Shqipërisë, që të kenë si pretekst për filluar përndjekjen ndaj Kishës Katolike. Mirëpo, siç dihet klerikët padyshim qenë patriotë të sinqertë, me opinione antikomuniste dhe me një besnikëri ndaj Kishës së përbotshme dhe atdheut. Kështu, ndjehej se fryma e përgjithshme e Kishës katolike në Shqipëri dhe gjithashtu pjesa më e madhe e shqiptarëve katolikë nuk e pranuan vullnetarisht komunizmin.

Në vitet në vazhdim rrëgjimi diktatorial që po instalohej iu imponua ashtu vjedhurazi si gjithë shqiptarëve edhe këtij komuniteti, çfarë do të kishte pasoja shkatërrimtare ndaj saj, organizimit kishtar, forcës intelektuale katolike, dhe rezervave humane e materiale.

Shqipëria e Veriut, që nga koha e pushtimit turk e në vazhdim, kishte traditë për sa i përket kryengritjeve kundër regjimeve të vlerësuar si të padrejta. Në këto kryengritje, kleri katolik pati gjithmonë një rol kryesor. Komuniteti katolik i drejtuar nga kleri i cili qe shkolluar në vendet perëndimore, ka qenë kundërshtari pasiv më i rëndësishëm dhe më serioz e i vetëdijshëm për komunistët shqiptaro-jugosllavë.

Megjithëse të nisur nga këndvështrime të ndryshme politike, komunistët shqiptarë, më 1945-1946, jo rastësisht, do të përsërisin në fushën arsimore të njëjtat politika goditëse ndaj klerit, kësaj here me pasoja fatale. Në realizimin e këtij objekti ata do ta kenë ngjarjen e viteve 1933-1936, si pikë të rëndësishme referimi.

Partia Komuniste e Shqipërisë e cila erdhi në pushtet në fund të vitit 1944, me ndihmën e partisë motër të popullit Jugosllav, ishte partia me famëkeqe në gjithë lëvizjen komuniste botërore. Si falënderim për ndihmën e dhënë, Hoxha i lëshon Josip Broz Titos të gjitha trevat etnike shqiptare, që deri në fund të vitit 1944 kishin qenë pjesë e

Mbretërisë së Shqipërisë.

Regjimi enverist i cili bashkëpunoj ngushtë me Jugosllavinë deri në vitin 1948, me një rigorozitet të jashtëzakonshëm propagandonte dogmatizmin marksizëm – leninizëm dhe ateizëm edhe më tepër se Tito. Pastaj, për 42 vjet ruajti pa ndërprerje regjimin e modelit sovjetiko – kinez, i cili ishte rrënjësor në të gjitha aspektet e jetës.

Kisha Katolike në Shqipëri në pragun e ardhjes së komunizmit kishte këtë strukturim: Kryedioqeza e Shkodrës, me udhëheqësin shpirtëror imzot Gaspër Thaçi; Kryedioqeza e Durrësit, me Imzot Vinçens Prenndushin, i cili administronte edhe Kishën Katolike të Shqipërisë së Jugut; Dioqeza e Sapës, me Imzot Gjergj Volaj; Dioqeza e Lezhës, me Imzot Luigj Bumçin; Dioqeza e Pultit, me Imzot Bernardin Shllakun dhe Abacia e Mirditës, me qendër në Orosh, e cila drejtohej nga Imzot Frano Gjini. Ndërsa, Delegati Apostolik më qendër në Shkodër, ishte Imzot Leone Nigris. Gjendja fetare në Shqipëri në vitin 1937 - 41, ishte kjo: Mysliman 72 % ose 720.000; Ortodoks, 20, 4 % ose 212. 233; dhe Katolik 10, 2 % ose 102.609. , Bektashianë, ishin 50.000.

### Filli i goditjeve ndaj klerit katolik

Në fund të marsit 1945, Enver Hoxha sërish thërret të Dërguarin Apostolik, Leone Nigrise dhe i kërkon që të shkoj në Romë, dhe t’ i paraqes Atit të Shenjte dëshirën e qeverisë shqiptare për të pasur marrëdhënie diplomatike me Vatikanin. Pasi Vatikani hezitoj ta pranoj një shtet komunist si Shqipëria, atij ju ndalua kthimi për në Shqipëri, si person i pa dëshiruar “persona non grata”. Po, në mars, regjim i komunist, filloj gjuetinë e përgjakur duke zhvilluar disa procese kundër klerikëve dioqezën, të cilët dënohen edhe me vdekje me “motivin” se nuk kishin mbajtur një qëndrim të mjaftueshëm armiqësor kundër Italisë dhe Gjermanisë. Viktimat e para që u pushkatuan në vitin 1945 ishin: poeti i ëmbëlsisë, Dom Ndre Zadeja, stilisti dhe përkthyesi i Schillerit dhe Goetës, Dom Lazer Shantoja, hartuesi i fjalorit shqip, Dom Nikollë Gazulli dhe dhjetëra intelektual katolik dhe mysli man nga Shkodra, shkruan Delegati Apostolik, Leone Nigris.

Qëndrimi i Komunisteve u ashpërsua pas miratimit të Kushtetutës në mars të vitit 1946. Sipas nenit 18 të këtij dokumenti “ të gjithë qytetareve u garantohet liria e ndërgjegjes dhe e fesë...për sa kohë ato nuk angazhohen në politik”. Kjo dispozitë e kushtetues false u ri konfirmua në rishikim e vitit 1950 dhe gjoja qëndroi në fuqi derisa ajo u zëvendësua nga legjislacioni gjatë Revolucionit Ideologjik dhe Kulturor në vitin 1960 dhe nga Kushtetuta e vitit 1976.

Imzot Frano Gjini ipeshkëv, me një letër i drejtohet Enver Hoxhës, në cilësinë e Delegatit

Apostolik, pas dëbimit të Leone Nigrise, ku Gjini ndër të tjera thekson, për dëshirën e të gjithë katolikëve për tu angazhuar për pajtimin dhe afrimin e shpirttrave si dhe padrejtësitë që u behën katolikeve në shtetin e ri etj.. Në mbyllje të letrës shprehet se “Duem me ndejun besnikë deri ne dekë (mendohet fesë), sikurse besnik duem me i ndejun deri në dekë Atdheut tonë të dashtun”. Kjo letër kishte mbetur pa përgjigje dhe u cilësua si akuzë ndaj sistemit. Në fund të vitit 1946, Imzot Gjini, arrestohet, dhe torturohet, akuzohet si spiun i Vatikanit, dhe i anglezeve dhe organizatori Kryengritjes së Postribës, pushkatohet në zall të Kirit në vitin 1948.

Pas ekzekutimit të Atë Anton Harapit, si anëtar i regjencës, në shkurt të vitit 1946, dëbohen të gjithë klerikët dhe anëtar të tjerë të urdhreve që nuk ishin nënshkruar shqiptarë, gjithsej rreth 80 misionar fetar.

Meqenëse botime e revistave: “Hylli i Dritës”, “Leka” dhe revistave të tjera fetare si: “Zani i Shna Ndout”, “Kumbona e së Diellës”, “Zgjimi i Djelmnisë”, “Bijati e Zojës”, librat dhe shkollat, për regjimin komunist cilësoheshin si një armë në luftën politike dhe ideologjike, një përçues i vijës dhe i programit të Partisë të masat dhe një brumosje e një njeriut të ri, më 6 mars 1946, erdhi urdhri i qeverisë për mbylljen e tyre. U asgjësuan të gjitha botimet mundshme dhe u mbyllën të gjitha shkollat katolike si: Françeskane, Jezuite, murgeshave Stigamtine dhe Servite si dhe ato në Tiranë. Duheshin shkrirë të gjitha shoqatat katolike dhe duhej konfiskuar pasuria e tundshme dhe e pa tundshme dhe kjo pasuri do konsiderohej shtetërore. Preh e përvetësimeve ishin: shkollat, kuvendet, tri tipografit, shtypshkronja e Jezuitëve, bibliotekat, muzetë, arkivat etj., të krijuara nga gjysma e dytë e shekullit XIX.

Pas shkatërrimit të pasurisë materiale dhe intelektuale, Enveri i rikthehet shkatërrimit të jetës fizike të klerikëve. Në shkurt të 1946 ë, shpallet Gjykata e Rrethit të Shkodrës në “Kinoteatrin Rozafat” për të ndëshkuar organizatën politike “Bashkimi Shqiptar”. Më këtë rast, akuza farsë u ngritën edhe kundër klerikëve si organizator të saj. Dhe me 2 mars, mbërrin miratimi i vendimit më vdekje për nderit Jezuit: Atë Giovanni Fausti, Atë Daniel Dajani, françeskanit Gjon Shllakut dhe seminaristit Mark Çuni. Më 4 mars, komunikohet ekzekutimi i kryer. Po i citojmë disa nga fjalët e fundit të tyre që janë më karakteristike. Dajani: “I fali ata që më kanë ba keq. Jam kondend se po vdes i pa faj, ma mirë se fajtuer”...; Fausti: “Jam kondend se vdekja po me vjen t'u krye detyrën temë. Dërgoni shëndet, jezuiteve, xhakonjeve, apostolikeve dhe arqipeshkvit. Rrnoftë Krishit Mbret”; Shllaku, “Lamtumirë m'i thoni shokëve françeskan dhe të gjithë të njohurve. Rrnoftë Krishtit Mbret- Rrnoftë Shqipëria” dhe Çuni, “I



fali të gjithë ata që më kanë gjykua, dënua dhe ata që do të më gjykojnë. I thoni nanës se i kam Lodovik Rashës 15 napolona borxh dhe t'ia paguej. Rrnoftë Krishti Mbretë- Rrnoftë Shqipëria”. Akuza false kundër njerëzve si dhe dënimi i tyre paraqet një nga kapitujt më të errët të historisë së drejtësisë shqiptare, theksojnë dëshmitarët e kohës.

Fushat komuniste envero- titiste, kundër klerikëve që shtrirë edhe në Kosovë. Në afërsi të Pejës më 13 shkurt të vitit 1943, që vranë nga UDB-ja Jugosllave, françeskani, Atë Lorenc Mitrovic-Massrreku, nga Janjeva; Atë Leonard Tagaj nga Ljara (Shestan) që vranë në famullin e Traboinit, më 12 shkurt 1946 dhe Atë Bernard Llupi, vranë në Prizren në vitin 1946, Dom Nikollë Tusha-Noga në Bijelashka Papretima, afër Cetinës, 1946. Ndërsa, Rakip Beqja, duke ironizuar vdekjet ndër të tjera thotë: “Por, më kotë endeshin këta krimba përpara grushtit të shtetit të fuqishëm të popullit dhe shpatës së zhveshur të diktaturës së proletariatit, që çdo ditë e më shumë po i godiste pa mëshirë duke bërë pluhur e hi ata dhe planet e tyre armiqësore”.

Një statistikë e vitit 1947, mbi burgjet tregon dukshëm se kleri katolik në raport me fetë të tjera, kur popullata katolike në Shqipëri ishin 10, 7 %, të burgosur nga kleri katolik kemi 37 %; klerik ortodoks (20 % e popullsisë), 16 %; dhe 47 % mysliman (72 % të popullsisë).

#### **Përndjekjet, ekzekutimet vazhdojnë (1946-1960)**

Regjimi komunist, për ta përfunduar procesin për nënshkrimin e fesë, nga vitet 1949- 1951, pos burgosjes dhe vrasjes të klerikëve, pra zhdukja nga faqja e dheut, do pastronte dhe krerët kishës - ipeshkvit. Në qoftë se nuk kishin vdekur ndërkohë nga shkaqet e keqtrajtimit siç ishte rasti i ipeshkvit të Lezhës, Luigj Bumçit, në mars 1945, apo kryeipeshkvit të Shkodrës, Gaspër Thaçit, në maj 1946, i cili vdiq në arrest shtëpie, në janar të vitit 1946 burgoset poeti i shquar, Kryeipeshkvi i

Durrësit, Vinçenc Prenndushi, jeta e të cilit mori fund në burg të Durrësit në vitin 1949. Radhën e pati dhe ipeshkvi i Sapës, Gjergj Volaj, i cili u pushkatua me 3 prill, 1948.

Ndërkohë regjimi nuk i harroj për të vazhduar eliminimin të klerikëve e thjesht, në vitet 1948 - 1949, do veçonim: Dom Aleksandër Sirdani, (1948) Dom Anton Muzaj, (1948), Atë Ciprijan Nika (1948) etj., kurse në vitin 1949, Dom Dedë Plani, Dom Jak Bushati, Atë Josip Papamihalji i rritit bizantin, Dom Mark Bici, etj..

Në vitin kur Shqipëria kishte prishur marrëdhëniet me Jugosllavin e nder kohë që po orientohej drejt Moskës, (1948-1961) situata kishtarë relativisht ishte me e qetë. Por, kjo i ngjante një moti kur po bëhej gati për një stuhi dhe një furtunë të re.

Ajo çfarë e karakterizon këtë periudhë rreth çështjes fetare nder të tjera ishte, riorganizimi i bashkësive fetare sipas direktivave të regjimit komunist.

Studiuesit janë të mendimit se përfundimi i nënshtrimit të fes nga shteti ateist, ka ndodhur pikërisht, kur bashkësitë fetare, në ligjin e dt. 26, nëntor të vitit 1949, mbi "Komunitetet Fetare", janë deklaruar "pro" urdhrit të Partisë dhe RPSH. Kisha Ortodokse këtë besnikëri e kishte shprehur, në gusht të vitit, 1949, ndërsa, Bashkësia Islame me 4 maj, 1950. Kisha katolike pasi në thelb të doktrinës se të saj kishte lidhjen e pandare me Vatikanin, pas një debati të gjatë dhe kundërshtie të ashpër, me 29 korrik 1951, me dhimbje të madhe e pranoi nënshkrimin e "Statutit" të firmosur nga 56 anëtar, duke i shkëputur lidhjet me Vatikanin, për tu nënshtruar drejtpërdrejtë autoritetit të shtetit. Kryetar i Bashkësisë Fetare Katolike, ishte i vetmi ipeshkëv i cili akoma ishte gjallë, ipeshkvi i Dioqezës së Pultit, Benardin Shllaku të cilin Mehmet Shehu, për një kohë të gjatë e kishte mbajtur peng në një qeli të Sigurimit të Shtetit. Rregulloren administrative Shllaku, ia dërgon me 4 shtator, Keshillit të Ministrave i cili me vendimin nr. 107 të 9 shkurtit 1952 jep miratimin e tij.

Pasi çdo gjë u mor nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit, në vitet në vazhdim një numër i klerikëve liroheshin nga burgu. Jeta pastorale në Kisha sikur filloj përsëri të ringjallej, duke kremtuar meshë në mënyrë solemne të dielave dhe festa

fetare. Pati dhe shugurime (kushtime), për meshtar si: Zef Pllumi, (1956, Kolec Toni dhe Zef Simoni (1961) Luigj Kçira (1963) etj., gjithsejtë nëntën vet. Gjithë ashtu pati dhe shugurime për ipeshkvi, si : Ernesto Çoba dhe Pjetër Dema, do shuguroheshin me 22 prill, 1952, Tonin Fishta, u shugurua për ipeshkëv nga Ernesto Çoba, me 25 prill, 1957, dhe me 18 prill 1958, Vatikanin emëron Nikollë Troshanin, ipeshkëv titullar, për administrimin e Kryedioqezës së Durrësit dhe Dioqezës së Lezhës, duke u shuguruar si ipeshkëv i Lezhës, në mars të vitit 1959.

Emërimet kryheshin sipas direktivave të shtetit dhe pa dijen e Vatikanit, por me vonë për shkak të kushteve rrethanore ato do pranoheshin nga ky i fundit.

Edhe pse dukej së Kisha kishte një frymëmarrje të lirë dhe ulje tensioni, kjo fazë (1950-1961) ishte me dredhi të mëdha, sepse proceset gjyqësore ndaj individëve vazhdoni të zhvilloheshin. Sepse, nga viti 1950-1959, kemi një varg klerikësh të dënuar që vdiqën nëpër burgje, kampe përqendrimi apo u pushkatuan, si: Dom Kolec Prenushi (1950), Dom Jul Bonati (1951), Dom Leon Ashiku (1950), Atë Karlo Sarreçi ( 1954) Benardin Shllaku, ipeshkëv (1956), Atë Bon Gjeçaj (1957), Dom Loro Cakaj (1956), Dom Luigj Gashi (1957), Dom Dedë Malaj (1959) e shume te tjerë.







# Mentor Quku

## 1939-2014

### JETA DHE VEPRIMTARIA

*Është shuar me 31, maj, 2014, në orët e para të mëngjesit në qytetin e Shkodrës, studiuesi i njohur Mentor Quku. Profesori u nda nga jeta në moshën 75-vjeçare në shtëpinë e tij, pasi vuajti për një kohë të gjatë nga një sëmundje e rëndë. U varros me 1 qershor, në varrezat Stom Golem të Shkodrës, ne pranin familjarëve, miqve, studiueseve, në pranin e hoxhallarëve dhe priftit katolik Dom Nikë Ukgjinit dhe zërit të kabanës se kishës Grudës se Re e cila si për mrekulli kumboi në momentin kur trupi i tij po prehej në varr. Ai njihet si mjedolog, për shkak se ia ka kushtuar gjithë jetën e tij studimit të veprës së poetit Ndre Mjeda. Pasi punoi për më shumë se 30 vjet në këtë lami, ai pat botuar një kolanë studimore shumëvëllimëshe.*

Mentor Quku ka lindur në Bilisht të Korçës më 20 janar 1939. U arsimua në Shkollën Pedagogjike "Shejnaze Juka" në Shkodër (1951-1954), kurse studimet e larta i kreu në Institutin e Lartë Pedagogjik në Tiranë (1955-1957) dhe pastaj në Universitetin e Tiranës (1960-1963).

Ka punuar mësues në shkollat e Shtiqënit, Brutit dhe Kukësit (1954-1957), në shkollën e mesme "Xheladin Fishta" në Shkodër (1961-1963), në shkollën e Barbullushit (1965-1991), në shkollën e Bahçallekut (1991-1992). Për veprimtarinë e tij pedagogjike, didaktike e mësimore është nderuar me medaljen "Mësues i merituar".

Si drejtor i Muzeut Historik Shkodër (1992-2000), ai ka organizuar, drejtuar dhe botuar, gjashtë seminare ndërkombëtare me titull "Shkodran në shekuj", si dhe ka drejtuar revistën "Kumtari".

Mentor Quku është autor i shumë artikujve dhe studimeve në fusha të ndryshme të dijes, si metodikë e mësimdhënies, pedagogji familjare, pedagogji shkollore, pedagogji sportive, tekstologji, psikologji e arteve figurative, psikologji sportive, psikologji moshore, histori, histori arti, letërsi biografike, letërsi për fëmijë, letërsi politike, histori e letërsisë për fëmijë, mitologji, folklor, frazeologji, toponomastikë. Ai ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare e ndërkombëtare, ku kontributi i tij ka qenë gjithmonë i mirëpritur.

Tema qendrore e kërkimeve dhe e studimoreve të Mentor Qukut mbetet figura e Ndre Mjedës, për të cilën ai ka punuar 30 vjet dhe ka botuar një kolanë studimore shumëvëllimëshe. Për t'u dokumentuar rreth jetës e veprës së Mjedës, ai ka shfrytëzuar arkivat e të gjitha vendeve ku Mjeda ka studiuar e punuar, ose që kanë ruajtur dokumentacion për Mjedën, si psh. Arkivi i Propaganda Fides, Arkivi i Jezuitëve Romë, fondi Peters Mahringer-Fonds (Austri), arkivat, bibliotekat dhe muzeut e Vjenës, si edhe arkiva e biblioteka të shumta në Gjermani, Francë, Poloni, Danimarkë, Spanjë, apo

kuvendet françeskane e jezuite të Bosnjës e të Kroacisë.

Botimin e plotë të kolanës studimore "Mjeda", autori Mentor Quku e përfundoi më 2014. Kjo kolanë, e botuar nga Shtëpia Botuese "Ilar" në vitet 2004-2014, paraqitet me këto vëllime:

Mjeda 1 (1866-1888): RINIA, fq. 642, 2004

Mjeda 2 (1888-1899): ALBANOLOGU, fq. 642, 2006

Mjeda 3 (1899-1912), i përbërë nga dy libra:

ALFABETI, fq. 680, 2007

LIRIA, fq. 766, 2008

Mjeda 4 (1912-1925): IDENTITET, fq. 634, 2009

Mjeda 5 (1925-1937): GJUHETARI, fq. 740, Tiranë, 2010

Mjeda 6, i përbërë nga dy libra:

BIBLIOGRAFIA (e Mjedës), fq. 325, Tiranë 2012

BIBLIOGRAFIA (mbi Mjedën), fq. 730, Tiranë 2012

Mjeda 7: BASHKEKOHESIT, fq. 494, Tiranë 2005

Mjeda 8: ALBUM, fq. 196, Tiranë 2010

Mjeda 9, PËRMBLEDHJE, fq. 254, Tirane, 2013.

Prof. Mustaf Dervishi, Tirane, 2013.

Mjeda, 2. PROZA, Qendra Muzeale "Ndre Mjeda", Tiranë 2014 (pas vdekjes).

Mjedisi intelektual i qytetit të Shkodrës, si edhe mbarë komuniteti i studiuesve të letërsisë shqipe, e kanë vlerësuar dhe e çmojnë në mënyrë të veçantë kontributin e Mentor Qukut, puna e të cilit tashmë shërben si referencë e pazëvendësueshme për studimet shqiptare, e në veçanti për studimet mbi Ndre Mjedën dhe mbi veprën e tij. Këtë e dëshmon, së fundi, edhe botimi i numrit të parë të revistës studimore "Mjedologji", e cila përmban njëzet punime mbi Ndre Mjedën nga studiues të konfirmuar të të gjitha trojeve shqiptare dhe i kushtohet mjedologut Mentor Quku.

Për kontributin e tij, Z. Mentor Quku është vlerësuar me medaljen "Mësues i Merituar" (1991) dhe "Mirënjohje e qytetit të Shkodrës" (2011). Mori titullin "Profesor Nderi", i Universitetit të Shkodrës 26 prill 2014.

**In somno pacis**

Frano Kulli

Lezhë

## Lamtumirë mjedologut Mentor Quku!

Lajmin e vdekjes së tij e mora parmbremë prej Dom Nikë Ukgjinit, njërit prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Mentor Qukut. Vepra e fundit që ata, tashmë e kishin përfunduar, thajse së bashku është Kukli i Ndre Mjedës, një unit arkitekturor e kulturor, ndoshta i papërsëritshëm në Shqipëri. Është shëmbëlltyra e një gjëje të dobishme, që mund të bëjnë njerëzit vullnetmirë në dobi të kulturës dhe etnogjenezës sonë kombëtare, me qetësinë e pabujshme, por dhe me dinamikën e ritmin e lartë me të cilin, kjo kategori e njerëzve dinë t'i bëjnë gjërat e dobishme, duke shpërfillur e sfiduar zhurmën e bujën që shoqëron shpeshherë, punë ndoshta shumë më të pakta, që bëhen në këtë fushë, sidomos Kukli, fshati ku poeti, gjuhëtari, politikani, atdhetari, Ndre Mjeda shërbeu për tridhjetë vjet, sot është padyshim një qendër e papërsëritshme pelegrinazhi, jo vetëm për këtë figurë monumentale të kulturës sonë, por ndoshta për gjithë trashëgiminë tonë kulturore kombëtare.

Pararendësi ishte pamëdyshje, Mentor Quku. I dashuruar që herët me këtë figurë shumëdimensionale dhe të përkorë të kulturës Shqiptare, Ndre Mjedën, ai e kishte nisur sendërtimin e saj, me hulumtimet dhe studimet e veta, rreth 50 vjet më parë kur ishte mësues atje. Botimet e atyre viteve, në shtypin shkencor e letrar të asaj kohe, qenë zanafilla e gjithë asaj që Mentor Quku, pasi është nisur për në botën tjetër ka lënë në p a n t e o n i n e trashëgimisë sonë kulturore. Një vepër jetëshkruese në dhjetë vëllime, me më shumë se 4000 faqe,

një lëndë-nektar e mbledhur edhe nga dëshmi të shumta të bashkëkohësve të Mjedës, por më pas nga arkivat e mëdha europiane të Romës, të Vjenës, të Polonisë, Gjermanisë, Amerikës... Mentori ia arriti të hedhë, kështu themelet e "Mjedologjisë", një institucioni studimor autentik shkencor. Numri i parë revistës "Mjedologjia 1" bashkëthemeluar gjithashtu prej tij, është edhe më e fundit dëshmi që la para se të mbyllte sytë. Por jam i bindur se nuk ishte as ideja e as projekti i tij i fundit. Njerëzit si Mentor Quku, që në jetën e vet hulumtuese e shkencore kishin ecur gjithnjë me progresion gjeometrik, janë dhe mbeten burim i pashtershëm frymëzimi, modele të përkryera që vlejnë për sot dhe për nesër. Nekrologji për studiuesin shkodran Mentor Quku, laurat i çmimit letrar "Serembe"(2008). Tema qendrore e studimeve të tij është ajo e Ndre Mjedës, për të cilin ka organizuar kërkime në Shqipëri, Kosovë e në shumë vende jashtë shtetit.

*Marrë nga gazeta:  
Shekulli, 2 qershor 2014.*



**Begzad BALIU**  
Prishtinë

## STUDIUESI QË NGRITI MONUMENTIN E NDRE MJEDËS NË LETRAT SHQIPE

Më 30 maj 2014 u nda nga ne studiuesi, intelektual dhe atdhetari i një formati të veçantë Mentor Quku. Lajmi për vdekjen e tij mbuloi me pikëllim jo vetëm Familjen e tij, por edhe institucione të tëra me të cilat ka bashkëpunuar, miqtë e shumtë anë e kënd hapësirës shqiptare dhe më gjer. Ndonëse kishte lindur në Bilisht të Korçës më 20 janar 1939 kanë qenë të paktë miqtë dhe të njohurit e tij që kanë besuar se Mentor Quku nuk ishte një shkodran mijëvjeçar. Përvoja e tij jetësore të kujton atë përvojë që në botimet historiko-letrare e kemi lexuar për Hil Mosin. Ai ishte shkodran që luftoi jo vetëm në malet e Shkodrës por edhe në Korçë, që disa nga poezitë e tij kryesisht me sfond epik i shkruante në gegnishte, ndërsa poezitë me përmbajtje më lirike në toskërishte. Mentor Qukut pati fatin që në rini të fillonte mësimet në Shkodër dhe t'i vazhdonte në Tiranë, për t'iu kthyer përsëri Shkodrës dhe zonave rurale të saj deri në veri (Kukës), por për një kohë shumë të gjatë në Barbullush (1965-1991), për tu rikthyer përsëri në Shkodër (drejtor i Muzeut) dhe i Seminarit Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj". Në shkollën e mesme "Shejnaze Juka", në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës dhe në Universitetin Shtetëror të Tiranës – Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Mentor Quku mori dijen akademike në fushë të edukimit dhe metodave të tij, prandaj ai punoi me shumë përkushtim jo vetëm në mjediset shkollë me nxënës, por si një pedagog me vetëdije historike që vinte nga një familje nacionaliste. Në stilin e një rilindësi punonte pa ndërprerë për të mbledhur gjithë trashëgiminë kombëtare, historike, etnografike e folklorike, gjuhësore e pedagogjike për t'i botuar apo prezantuar në mjediset shkencore e kulturore, ku jetonte apo edhe në qendra më të mëdha si Shkodra e Tirana. Gjatë kësaj periudhe ai botoi edhe një mal tekstesh pedagogjike e psikologjike për shoqërinë, familjen dhe shkollën. Pas rënies së sistemit komunist në Shqipëri Mentor Qukut ju hapën mundësitë për të përmbushur pasionet e tij prej hulumtuesi e studiuesi në fushë të trashëgimisë kombëtare, në veçanti studimet për Ndre Mjedën. Në Shkodër ai drejtoi jo vetëm Muzeun e Shkodrës po edhe Seminarin Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", rreth të cilit mbledhi disa qindra studiues jo

vetëm nga Shqipëria e Kosova po edhe nga Europa e Amerika. Për më shumë se dy dekada ai more pjesë edhe në shumë konferenca shkencore e kulturore, në të cilat në të shumtën e rasteve ai sillte rezultatet më të reja për Mjedën.

### Themeluesi i mjedologjisë dhe institucionalizimit

Kolana e studiuesit Mentor Quku për Ndre Mjedën, në studimet filologjike shqiptare është përpjekja e parë e një studiuesi për të sjellë të plotë gjithë pasurinë materiale e shpirtërore të njërës prej shkrimtarëve të veçantë të letrave shqipe dhe një përvojë e jashtëzakonshme për të gjithë hulumtuesit shqiptarë që një ditë do të provojnë të bëjnë objekt studimi periudha, ngjarje, personalitete apo vepra të caktuara historike, letrare apo kulturore të traditës a të sotmes sonë. Mentor Quku, është shembulli më i mirë i punës afatgjatë dhe të durueshme për të na e dhënë sa më të plotë jetën dhe veprën e një





shkrimtari. Ai ka dëshmuar se kërkimet dhe sintezat e mëdha historiko-letrare nuk janë çështje e një projekti, doktorate apo konference, po çështje të një jete. Në këtë Kolanë ai na ka dhënë vit pas viti nga 2004-2013 çdo ditë shkrimtarin dhe studiuesin Ndre Mjeda, si dhe veprën letrare e shkencore të tij jashtëzakonisht të plotë në trembëdhjetë vëllime: Mjeda 1 (1866-1888): *RINIA*, 2004; Mjeda 2 (1888-1899): *Albanologu*, 2006; Mjeda 3 (1899-1912), i përbërë nga dy libra: *Alfabeti*, 2007; *Liria*, 2008; Mjeda 4 (1912-1925): *Identitet*, 2009; Mjeda 5 (1925-1937): *Gjuhëtari*, 2010; Mjeda 6, i përbërë nga dy libra: *Bibliografia* (e Mjedës), 2012; *Bibliografia (mbi Mjedën)*, 2012; Mjeda 7: *Bashkëkohësit*, Tiranë 2005; Mjeda 8: *Album*, 2010; Mjeda 9, *Përmbledhje*, 2013, sado kemi menduar se kemi qenë mjaftueshëm të njohur me të. Përkundrazi, studiuesi Mentor Quku na e ka dhënë Mjedën në një format të pazakonshëm, në të cilin është përfshirë një pasuri e madhe dokumentesh, ngjarjesh, sintezash, vlerësimesh, fotografi, fototipe letrash dhe tekste – autografe, si dhe në raste të caktuara edhe versione e tekstesh të krijimtarisë së tij letrare. Këto të fundit madje kryesisht vetëm në nivel të sprovave për një paraqitje të plotë në vëllime të veçanta, sikur duket të jenë projektuar nga autori, pasi të ketë përfunduar edhe vëllimin e dhjetë për Ndre Mjedën. Në studimet albanologjike të dy dekadave të fundit, shpesh është shtruar çështja e botimit të veprave të autorëve të panjohur deri më tash, si kusht për të shkruar historinë e plotë të letërsisë shqipe. Kjo kërkesë është plotësuar e po plotësohet, kur më pak e kur më shumë, dhe jo vetëm në një mënyrë. Një mënyrë tepër të veçantë këtë e ka bërë studiuesi i përkushtuar Mentor Quku, duke dhënë shembullin e punës afatgjatë dhe të durueshme për të na e dhënë sa më të plotë shkrimtarin dhe studiuesin Ndre Mjeda, si dhe veprën letrare e shkencore të tij, për të cilin kemi menduar se kemi qenë mjaftueshëm të njohur. Kjo është arsyeja pse ende pa përfunduar kjo kolanë, para autorit shtroheshin kërkesa të reja, sikur janë: botimi tekstologjik i veprës letrare të tij, botimi filologjik i veprës gjuhësore të tij, botimi i një vëllimi me studime të pabotuara, pjesën më të madhe të të cilit sigurisht do ta zinte dorëshkrimi i Profesor Jup

Kastratit, në rreth 160 faqe makine shkrimi, botimi i një a dy vëllimeve me studime të zgjedhura nga të gjitha periudhat dhe nga e gjithë hapësira shqiptare, po edhe nga të gjitha gjuhët në të cilat janë shkruar artikujt për Mjedën. Në këtë mënyrë, shpresonim që Ndre Mjeda të japë shembullin e paraqitjes komplekse dhe shumëpërmbajtësore të veprës së Mjedës. Vetëm pasi të kemi veprën e tij të plotë dhe variantet e saj, ne do ta kemi të plotë dhe të sigurt *Fjalorin e gjuhës së Ndre Mjedës*, një vëllim (dorëshkrim), i të cilit tashmë ka një gjysmëshekulli që është përgatitur; vetëm pasi ta kemi të plotë veprën e tij, ne do të mund të përgatisim jo vetëm *Fjalësin e gjuhës së veprës së tij*, po edhe *Fjalorin e termave estetike të tij*, *Fjalorin e rimës së pasur të tij*, ndikimin e shkollës austriake në mendimet gjuhësore të tij dhe sidomos ndihmën që Mjeda ju dha disa prej albanologëve më të shquar të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX. Gjatë kësaj periudhe, kryesisht në dy dekadat e fundit, Mentor Quku mori edhe vlerësimet e institucioneve shkencore, kulturore e arsimore pranë të cilave punoi: Medaljen “Mësues i Merituar” (1991); “mirënjohjen e qytetit të Shkodrës (2011) dhe së fundit titullin “Profesor Nderi” i Universitetit të Shkodrës.

### Lamtumirë miku im!

Profesor Mentor Qukun e kemi njohur prej më se dy dekadash. E kemi njohur prej veprave të tij, e kemi vlerësuar për bëmat e tij në institucionet kulturore e shkencore dhe e kemi çmuar për veprimtarinë e tij në ndërtimin e një





bote shkencore gjithëshqiptare. Duke bashkëpunuar për Seminarin ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, duke organizuar shumë aktivitete mes Prishtinës e Shkodrës dhe duke komunikuar shpesh, tepër shpesh, Profesor Mentor Qukun e kishim emër të përveçëm në në jetën tonë. Në këtë mënyrë, me punën e tij, me ngrohtësinë miqësore që ofronte, me parimet e komunikimit që reflektonte Profesor Mentor Quku, Shkodrën na e patë bërë më të afërt se kryeqytetin e moçëm Prizrenin dhe kryeqytetin e tanishëm Tiranën, më të ngrohtë se Durrësin apo se vendlindjen time Gjilanin. Në të vërtetë hapësirën etnike na e patë njësuar në ato përmasa që nuk e kemi njohur më parë. Në jetën tonë kulturore e shkencore, në miqësinë tonë të paskajshme, Profesor Mentor Qukun do ta kujtojmë për përkushtimin e tij në hulumtimin dhe studimin e jetës dhe veprës së Ndre Mjedës. Qindra letra, mesazhe, aktivitete, komunikime nga më të ndryshmet me të dhe miqtë tanë anë e kënd globit lidhen me kërkimet e tij në gjurmë të trashëgimisë së Ndre Mjedës dhe institucioneve a veprave shkencore, fetare e letrare që ruanin. Miqtë e tij dhe miqtë tanë qenë bashkuar dhe njohur pikërisht rreth një qëllimi: hulumtimit të jetës dhe veprës së Ndre Mjedës. Ata tashmë

përbëjnë një institucione virtual, të cilin e drejtojnë pa zhurmë dhe mburrje, por me vullnet e dashamirësi Mentor Quku. Në këtë mënyrë, Ai e ngriti Mjedën në ato përmasa kërkimore e institucionale, të cilin zor se mund t'ua përshkruajmë bardëve të letërsisë shqiptare: Gjon Buzukut apo Jeronim De Radës, Naim Frashërit apo Gjergj Fishtës. Duke e njohur vullnetin e tij për të çuar larg misionin e kërkimeve shkencore, modelet e së cilave i ka të pakta dija shqiptare dhe madje ajo e rajonit dhe duke bashkëpunuar në shumë nga këto aktivitete, nuk na kishte shkuar mendja se në këtë rrugë mund ta ndërprente kush fundin e tij, për të mos thënë, vdekjes sikur ia kishim kthyer shpinën, sepse kishim punë shumë më të rëndësishme se ajo. Por ja që ai iku. Ndoshta nuk e kishim kuptuar ne, sepse Ai kishte shumë dekada që jetonte me trupin dhe frymën e tij mes thellësisë tokësore të kërkimeve të antikitetit mjedian dhe frymës qiellore të bardit shpirtëror të tij, Ndre Mjedës. Tashmë ai i realizoi të dyja, ndërkohë që ne ende nuk duam ta besojmë, sepse nuk mund ta kuptojmë mungesën fizike të tij mes nesh.

**Marrë nga gazeta:  
TELEGRAF, dt. 2. 06. 2014**

## DEKORIMI I PROF. MENTOR QUKUT

### Një vlerësim për punën 40 vjeçare për poetin Mjeda.

**Prof. Artan Haxhi**  
Rektori i Universitetit të Shkodrës

Shkodër, më 26 prill 2014

*Studiuesit të njohur të Ndre Mjedës i jepet titulli i lartë “Profesor Nderi”. Ceremonia u zhvillua me, 26 prill 2014, në sallën shkencore të bibliotekës të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Senati i këtij universiteti me kryetar rektorin Prof. Dr. Artan Haxhi, vendosi me datë 16. 4. 2014, në mënyrë unanime që ti jepet Z. Mentor Qukut titulli i lartë “Profesor Nderi” me motivacion “Për kontribute të veçanta në studimet mjedologjike dhe si iniciator i veprimtarisë shkencore disa vjeçare “Shkodra në shekuj”, realizuar në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës”.*

Të nderuar pjesëmarrës!

E vlerësova jashtë mase pjesëmarrjen në këtë veprimtari kulturore për dy arsye, që më duken shumë të rëndësishme.

Së pari, përmbledhja studimore “Mjedologji” e cila po promovohet sot sjell të botuara kumtesat e studiuesve të hapësirës shqiptare kushtuar figurës së viganit të letrave shqipe, dom Ndre Mjedës. Siç thuhet edhe në parathënie qëllimi i botimit të kësaj kolane është zbulimi i të vërtetave mbi jetën dhe veprën e njëres prej figurave më të shquara të kulturës kombëtare...

Në fakt botimi i akteve shkencore të dy konferencave nën titullin “Mjedologji” përbën një tjetër kontribut për evidentimin dhe vlerësimin e veprës së Mjedës, duke ndriçuar aspekte të shumanshme të personalitetit kompleks të kësaj figure të shquar dhe të veprës së tij. Përmes kësaj përmbledhjeje vijnë punime të studiuesve të spikatur, si : Kolec Topalli, Gjovalin Shkurtaç, Tomor Osmani, Alfred Çapaliku, Shaban Sinani, Fatbardha Fishta, Nikë Ukgjini, Klara Kodra, Mark Marku, etj., duke e shndërruar këtë kolanë në një tribunë të rëndësishme të mendimit shkencor.

Arsyeja e dytë, është se ne me këtë rast do të bëjmë një nderim të veçantë për atë që iu përkushtua studimit të jetës dhe të veprës së Ndre Mjedës, njërit prej hulumtuesve më të shquar të tij, studiuesit Mentor Quku. Po citoj disa rreshta që më kanë bërë përshtypje nga parathënia e veprës “Mjeda I”:

*“Tani që kam vendosur të botoj në bllok studimet e mia 30-vjeçare mbi dom Ndre Mjedën, e ndjej të domosdoshme të sqaroj lexuesin për lidhjet shpirtërore që kam pasur me këtë figurë madhore të kombit shqiptar. Këto lidhje kanë pasur një nxitje, një fillim, si dhe një histori. Këto gjëra dua t’ia sqaroj lexuesit para se të filloj të shkruaj punën e jetës sime. Kjo përbën një provë të sinqeritetit tim, të cilit i jap rëndësi, sidomos në këto momente...”*



Kjo qasje e singertë e autorit ndaj objektit studimor, figurës së Ndre Mjedës, një nga më tërheqëset në mbarë historinë e letërsisë shqiptare dhe dëshira për të komunikuar me një lexues sa më të gjerë e bëjnë veprën studimore të Mentor Qukut një shembull domethënës për kërkuesit shkencorë, të rinj apo me përvojë qofshin.

Studimi voluminoz dhe shteruese i këtij autori është një kontribut i vyer për mbarë shkencën shqiptare dhe veçanërisht për albanologjinë dhe historinë e letërsisë shqipe. Ai përbën një nga shtyllat e burimeve bibliografike për Ndre Mjedën.

Nisur nga ky kontribut i cilësuar në lëmë të shkencës, por edhe nga bashkëpunime të tjera të vazhdueshme të z. Quku me Universitetin e Shkodrës, Senati akademik i këtij Universiteti, mbështetur në propozimet e departamentit të Letërsisë, të Institutit të Studimeve Albanologjike dhe të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në mënyrë unanime miratoi dhënien e titullit :

*“Profesor nderi i Universitetit të Shkodrës”*  
për z. Mentor Quku.

I urojmë prof. Qukut jetë të gjatë e shëndet të plotë në vijimin e punës së tij në dobi të shkencës.  
Faleminderit !



**PROF. MENTOR QUKU,**  
**“Studimet e mia mbi Mjedën filluan plot 40 vjet përpara”**

*Shkodër, 26 prill, 2014.*

*I nderuar zoti zv.ministër i kulturës,  
I nderuar zoti Kryetar i Këshillit Qarkut,  
I nderuar profesor Artan Haxhi rektor i Universitetit Luigj Gurakuqi - Shkodër,  
I nderuar profesor Ardian Marashi, drejtor i Qendrës Studimore Albanologjike,  
E nderuara profesor Mimoza Priku, dekane e Universitetit Luigj Gurakuqi -Shkodër  
I nderuari Doktor Dom NikëUkgjini, drejtor i Qendrës muzeore Ndre Mjeda  
Të dashur miq dhe kolegë, Të nderuar pjesëmarrës,*

ju falënderoj nga zemra për kontributin që keni dhënë me rastin e dekorimit tim, me titullin e lartë “Profesor Nderi”. Ky titull do të jetë për mua jo vetëm vlerësim por edhe nxitje e madhe për të vazhduar punën shkencore. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj me mirënjohje të thellë të gjithë ato miq dhe dashamirës që në çaste të vështira për mua dhe familjen time u bënë krah duke më mbështetur dhe duke më dhënë kurajë për të ecur përpara; në projektet e mia për shkencën dhe kulturën kombëtare. Unë pata fatin që të njihja gjatë rrugës time studimore njerëz që më ndihmuan konkretisht e që sot i kam miq, shokë dhe bashkëpunëtorë. Gjatë jetës sime kam përjetuar shumë sfida të cilat i kam përballuar me ndihmën e familjes e në



mënyrë të veçantë të bashkëshortes sime, e cila nga dita në ditë është bërë një bashkëpunëtorë e pazëvendësueshme.



Studimet e mia mbi Mjedën filluan plot 40 vjet përpara (që në vitin 1974). Që në fillimet e mia për realizimin e projektit Mjeda kam njohur njerëz që e kuptuan idenë time për të mbështetur metodikën që më çonte drejt arkivave dhe burimeve origjinale. I përshëndes gjithashtu në mënyrë të veçantë. Gjithnjë më kanë bërë përshtypje të madhe idealistët, edhe pse ato nuk kanë qenë në modë. E pra unë jam përpjekur të jem njëri prej tyre. Së fundi ju kërkoj të gjithëve të falur për mungesën time në këtë sallë por do t'ju shpërblej: duke botuar brenda këtij viti 2 volume të reja: “Mjeda Poezia” dhe “Mjeda Proza”. Gjithashtu duke shpresuar tek i madhi zot do të jem shpejt i gatshëm të marr pjesë në aktivitetet e juaja.

***Me respekt, Mentor Quku***

*Për shkak të gjendjes të renduar shëndetësore  
letra u lexua nga e bija, Valbona Lisha-Quku.*

# MENTOR QUKUT I JEPET TITULLI “PROFESOR NDERI” I UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI” TË SHKODRËS



Studiuesit të njohur të Ndre Mjedës i jepet titulli i lartë “Profesor Nderi”. Ceremonia u zhvillua me, 26 prill, 2014, në sallën shkencore të bibliotekës të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Senati i këtij universiteti me kryetar rektorin Prof. Dr. Artan Haxhi, vendosi me

datë 16. 4. 2014, në mënyrë unanime që ti jepet Z. Mentor Qukut titulli i lartë “Profesor Nderi” me motivacion “Për kontribute të veçanta në studimet mjedologjike dhe si iniciator i veprimtarisë shkencore disa vjeçare “Shkodra në shekuj”, realizuar në bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës. Në ceremoni merrnin pjesë intelektualë, studiues, kolegë e të ftuar si dhe shumë miq e pjesëtarë të familjes.

Mbledhjen e hapi drejtori QSA Prof. Ardian Marashi i cili në fjalën e tij theksoi se kolana me 10 vëllime të Mjedës, vepër e shquar e studiuesit Mentor Quku është një kontribut i madh në fushën e studimeve albanologjike. Në fjalën përshëndetëse Prof. Mimoza Priku foli për kontributet e Mentor Qukut. Përshëndeti gjithashtu zv. Ministri i Kulturës Zef Çuni i cili foli



për rolin e dukshëm që ka luajtur Mentor Quku në ngritjen e Qëndrës Muzeore Ndre Mjeda si dhe në studimet mjedologjike.

Mbas fjalëve përshëndetëse u zhvillua ceremonia e dorëzimit të titullit të lartë “Profesor Nderi” zonjës Ixhlal Quku bashkëshortes së Mentor Qukut. Në emër të Prof. Qukut, i cili mungonte për arsye shëndetësore lexoi tekstin e mirënjohjes e bija Valbona Quku Lisha.

Me rastin e nderimit të prof. Mentorit, u promovua dhe revista “Mjedologji 1”, e cila përmban temat e dy konferencave për Mjedën, kushtuar mjedologut Mentor Quku.

U mbajtën disa ligjërata nga Profesor të Universitetit Luigj Gurakuqi. Ligjëroi Fatbardha Hoxha, mbi profilin shumë dimensional të

studiuesit Mentor Qukut. Më tej, Rezarta Draçini, ligjëratën me bashkëautor Tef Topallin “Mjedologjia e gjuha”. Elinda Ramadani, mbajti kumtesën “Studimet letrare dhe Mjedologjia”, ndërsa Alfred Çapaliku, “Përmendorja e Mjedës”.

Aktiviteti u gërshetua me çaste artistike ku Merita Smaja, recitoi poezi të njohura të Mjedës. Pati një pjesëmarrje të madhe të intelektualëve si dhe interesimi ishte i madh i qytetarisë Shkodrane.







Konferenca Ipeshkvnore  
e Shqipërisë

1700 VJETORI I EDIKTIT TË  
MILANOS


Gjergj Fishta, Lezhë 2014



Papa Françesku

GËZIMI I UNGJILLIT

Ylber, Tiranë 2014



Mentor Quku

MJEDA 2 - Proza

Ilar, Tiranë 2014

### KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore  
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë

(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n\_ukgjini@yahoo.it

Web page: [www.kishakatolikeshkoder.com](http://www.kishakatolikeshkoder.com)

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,

Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë